



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0106**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Kodi“0811” kundër njoftimit për dhënie të një kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Kompleksin Qendra e ISSH dhe QIRSKP ne Shtime” me nr. të prokurimit: "206-23-10983-4-1-3", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë më 12/04/2024, mori këtë

## **Vendim**

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “Kodi“0811” me nr. 2024/106, e datës 08.02.2024 lidhur me aktivitetin e “Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Kompleksin Qendra e ISSH dhe QIRSKP ne Shtime” me nr. të prokurimit: "206-23-10983-4-1-3", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankesues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 11.10.2023 “Kodi“0811” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Kompleksin Qendra e ISSH dhe QIRSKP ne Shtime” me nr. të prokurimit: "206-23-10983-4-1-3". Ndërsa me datë 19. 01. 2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE “9090”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës:300,000.00 €.

Me 24. 01. 2024, OE “Kodi“0811” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 29. 01. 2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Kodi“0811” me nr. 106/2024 lidhur me aktivitetin “Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Kompleksin Qendra e ISSH dhe QIRSKP ne Shtime” me nr. të prokurimit: "206-23-10983-4-1-3".

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

1. Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Kodi 0811” janë parashtruar si në vijim:

Sqarim Hyrës: “Të pa kënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 Rezultatit e Konkursit të Vendimit për Refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim të AK-se të datës 24.01.2024. Bazuar në arsyetimin e Vendimit për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim kemi hasur se AKMSH, ka caktuar Jurinë Profesionale konform nenit 80 të LPP-se në përbërje prej tre (3) Inxhinierëve të arkitekturës por nuk ka specifikuar sa vite përvojë pune kanë pasur pas diplomimit si dhe a kanë poseduar kualifikim - Inxhinier i diplomuar i arkitekturës, sistemi 5 vjeçar ose Master, si dhe përvojën e punës në cilësi të Projektuesit përgjegjës. Bazuar në faktet e lartpërmendura pretendojmë se Juria profesionale nuk ka poseduar kualifikimin përkatës - Inxhinier i diplomuar i arkitekturës, sistemi 5 vjetar ose Master (min. 5 vjet përvojë nga diplomimi) si dhe nuk kanë poseduar përvojën e punës në cilësi të projektuesit përgjegjës. Në vazhdim do t'i paraqesim të gjitha argumentet rreth të metave të projektit të OE 9090.

Pretendimi i parë (I): “Operatori Ekonomik 9090 ka bërë vendosje të pafavorshme të objekteve në raport me terrenin ekzistues. Fillimisht, parcela kadastrale 00434-2, në të cilën do të ndërtohet kompleksi në fjalë, ka një konfiguracion kodrinor të terrenit mjaft të papërshtatshëm për ndërtim. Kjo parcelë ka një pjerrtësi të madhe të terrenit, me disnivel prej 30 metrave, nga hyrja e parcelës deri te fundi i saj. Në kuadër të dokumentacionit të pranuar nga Autoriteti Kontraktues, është edhe situacioni me izohipse-model dhe koordinatat e incizimit, të cilat e pasqyrojnë gjendjen reale të parcelës në fjalë. OE 9090 i ka pozicionuar objektet në të kundërtën e shtrirjes së terrenit ekzistues, respektivisht përgjatë pjerrtësisë maksimale të terrenit ekzistues. Te objekti i ISSH, kuota e lartësisë së suterrenit e paraqitur në projekt është -3.50 metra. ndërsa kuota e terrenit ekzistues sipas izohipseve (në fund të suterrenit) është -11 metra dhe si rezultat i kësaj, objekti qëndron komplet mbi tokë dhe për tu funduar në terrenin natyrorë, duhet të punohen pilota ose themele në lartësi prej rreth 7.50 metra mbi tokë. Një fundim i tillë është i domosdoshëm, sepse objekti nuk guxon të vendoset mbi terren të shtuar (artificial). Te objekti i QIRSKP, kuota e lartësisë së suterrenit 2 e paraqitur në projekt është -7.00 metra, ndërsa kuota e terrenit ekzistues

sipas izohipseve (në fund të suterrenit) është -12 metra dhe si rezultat i kësaj, objekti qëndron komplet mbi tokë dhe për t'u funduar në terrenin natyrorë, duhet të punohen pilota ose themele në lartësi prej rreth 5.00 metra mbi tokë. Një fundim i tillë është i domosdoshëm, sepse objekti nuk guxon të vendoset mbi terren të shtuar (artificial). Një vendosje e tillë është e pafavorshme në aspektin konstruktiv, ekonomik, funksional dhe mjedisor: -në aspektin konstruktiv kërkohet analizë e veçantë dhe kosto e shumëfishtë për këtë realizim, -në aspektin ekonomik është kosto e shumëfishtë, sepse kërkohet të ekzekutohen themele në lartësi të 2 etazhave (7.50 metra), investim për mbushje të madhe me terren artificial, investim për stabilizim të terrenit të shtuar-artificial, etj. -në aspektin funksional është sfidë e shtuar e projektit për lidhje të nivelit të propozuar me projekt dhe nivelit të terrenit natyrorë dhe eliminimin e barrierave në lëvizje, -në aspektin mjedisor është ndërhyrje ekstreme në terrenin natyror dhe konfiguracionin ekzistues të terrenit, çka paraqet shkatërrim të madh natyror, devijim të madh të rrjedhjes natyrore të ujërave mbitokësore dhe nëntokësore, etj. Përfundimisht, ky pozicionim i objekteve e rrezikon edhe realizimin e tyre, sepse është ndërmarrje inxhinierike dhe ekonomike, që i tejkalon kushtet e këtij projekti.”

Pretendimi i dytë (II): “Operatori Ekonomik 9090 nuk e ka respektuar Detyrën Projektuese sa i përket planifikimit dhe pozicionimit të objekteve në kuadër të parcelës. Sipas detyrës projektuese të konkursit kërkohet: “...Hyrjet do te locohen ne te njëjtin vend, por te ndara...” (Kapitulli: Funksioni dhe organizimi, faqe 4), ndërsa propozimi në fjalë hyrjet dhe objektet i ka vendosur në pozita gati të skajshme të parcelës, që e dëmton shumë aspektin funksional të kompleksit.”

Pretendimi i tretë (III): “Operatori Ekonomik 9090 nuk e ka respektuar Detyrën Projektuese sa i përket planifikimit dhe pozicionimit të objekteve në kuadër të parcelës dhe lidhjes funksionale mes objekteve. Sipas detyrës projektuese të konkursit kërkohet: “...Organizimin e hapësirave të brendshme dhe funksionalitetin e tyre për të dy komplekset (ISSH dhe QIRSKP) si dhe ndërlidhja ne mes tyre...” (Kapitulli: Funksioni dhe organizimi, faqe 1), ndërsa propozimi në fjalë e nuk ka planifikuar asnjë lidhje të tillë të kontrolluar dhe e ka eliminuar mundësinë për lidhje organike me tyre.”

Pretendimi i katërt (IV): “Operatori Ekonomik 9090 ka mospërputhje të sipërfaqeve të prezantuara në pjesën grafike të projektit dhe në tabela dhe kjo është vërtetuar prej matjeve nga materiali digjital Gjithashtu, Operatori Ekonomik 9090 ka prezantuar mos organizim adekuat të përmbajtjeve të objekteve dhe si rezultat i kësaj ka humbje të mëdha edhe të sipërfaqeve. Të dy objektet, ISSH dhe QIRSKP, kanë sipërfaqe të tejkaluar prej kërkesave të Detyrës Projektuese. Objekti i ISSH ka sipërfaqe totale bruto prej rreth 6960 m<sup>2</sup>, ndërsa objekti QIRSKP ka sipërfaqe totale bruto prej rreth 9211 m<sup>2</sup>. Krahasuar me propozimin tonë teknik (OE 0811: ISSH=5982 m<sup>2</sup> dhe QIRSKP=7292 m<sup>2</sup>), OE 9090 në total ka rreth 2897 m<sup>2</sup> më tepër. Ky tejkalim rezulton me kosto shtesë të ndërtimit (rreth 1 500 000 euro) dhe kosto shtesë të mirëmbajtjes së përhershme dhe shpërdorim të panevojshëm të parasë publike“.

Pretendimi i pestë (V): “Operatori Ekonomik 9090 ka paraqitur planimetri me konstruksion të pa definuar dhe në raste të caktuar të lajthitur me qëllim, aty ku ndonjë shtyllë e ka penguar në organizim. Gjithashtu, në raste të shumta, shtyllat janë të organizuara në mes të dhomave, në mes të shtretërve, në mes të orendive, gjë që pengojnë në funksionimin normal të objektit. Planimetria e objekteve është e shtrirë, me distanca të mëdha dhe e çrregullt. Projektuesi nuk ka paraqitur askund fuga dilatuese, që në fakt duhet të paraqiten në fazën e projektit ideor. E tërë kjo paraqet mangësi të mëdha në projekt, sepse e imponon ndryshimin radikal të projektit ideor nga projekti zbatues i mëvonshëm, nëse synohet që objekti të ketë strukturë të qëndrueshme dhe

funksion standard sipas kërkesave për këto lloj objekte.”

Pretendimi i gjashtë (VI): “Operatori Ekonomik 9090 nuk ka prezantuar fare projekt për asnjë nga përmbajtjet e jashtme, mirëpo disa prej tyre shihen vetëm në situacion. Kërkesa nga detyra projektuese është e qartë dhe kërkohet të ketë propozim nga projektuesi. Përmbajtjet për të cilat nuk ka projekt janë: -te pjesa e ISSH mungojnë: Zyre për roje, Këndi i lojërave /fushë futbollit/ basketbollit, Sera për mbjelljen e luleve dhe perimeve, Rezervar të ujit me kapacitet deri në 10,000 litra , 2 copë në rastet e reduktimeve apo ndërprerjeve të ujësjellësit të qytetit, -te pjesa e QIRSKP mungojnë: Zyre për roje, Barbique për 30 persona, Fusha e basketbollit, Fusha e mini-futbollit, Mini amfiteatri - 60 persona, Këndi i aktiviteteve - lojrave argëtuese, Ujëvara me mini lumin artificiale gjatësi rreth 20-30 m, për rehabilitim, Sera bujqësore me kapacitetet minimale (për terapi të punës për pacient). Ky argument paraqet mosplotësim të kërkesave nga Detyra Projektuese dhe këto mungesa nuk janë reflektuar fare në vlerësimin e jurisë dhe i njëjti është vlerësuar me pikët maksimale nga të gjithë konkurrentët.”

Pretendimi i shtatë (VII): “Operatori Ekonomik 9090 ka prezantuar pjerrina jofunksionale për lidhje të etazhave, të cilat shfrytëzohen nga banorët rezidentë. Lidhja e etazhave me pjerrinat e prezantuara është komplet jofunksionale dhe e bën objektin jofunksional, sepse: nuk i ka prezantuar në mënyrë reale gjatësitë e pjerrinave dhe me zgjidhjen e prezantuar i ka shtrembëruar faktet: te ISSH pjerrtësia e pjerrinës së paraqitur është 6%, lartësia e katit 3.50 metra dhe matematikisht gjatësia e pjerrinës për të arritur nga kati në kat duhet të jetë 58.33 metra, ndërsa në projekt është vetëm 47 metra pa pushimore; te QIRSKP pjerrtësia e njëjës pjerrinë të paraqitur është 5%, lartësia e katit 3.50 metra dhe matematikisht gjatësia e pjerrinës për të arritur nga kati në kat duhet të jetë 70 metra, ndërsa në projekt është vetëm 49 metra pa pushimore, te QIRSKP pjerrtësia e pjerrinës tjetër të paraqitur është 5%, lartësia e katit 3.50 metra dhe matematikisht gjatësia e pjerrinës për të arritur nga kati në kat duhet të jetë 70 metra, ndërsa në projekt është vetëm 51 metra pa pushimore, -të gjitha pjerrinat janë të projektuara pa pushimore, ndërsa sipas normave -pjerrinat për këtë lloj të objekteve- nuk mund ta tejkalojnë gjatësinë prej 10 metrave pa pushimore (d.m.th. çdo 10 metra duhet të ketë pushimore në gjatësi prej 1.50 metra). Në bazë të kësaj, këto pjerrina janë jofunksionale, në secilin rast, edhe nëse modifikohet pjerrtësia e pjerrinave (nga 5% dhe 6% në 8%) dhe shtohen pushimoret, për këtë formë të organizimit të propozuar nga OE 9090 nuk mund të realizohen pjerrinat sipas standardeve të kërkuara. Duke u bazuar në rëndësinë substanciale të pjerrinave për këtë lloj të objekteve, si dhe duke u bazuar në të dhënat e Argumentit 7, projekti i propozuar nga OE 9090 nuk mund të kualifikohet si pretendent për projekt ekzekutues, sepse ka të meta që e dëmtojnë substancialisht funksionin”.

Pretendimi i tetë (VIII): “Operatori Ekonomik 9090 e ka dorëzuar propozimin me një prezantim grafik që nuk i plotëson kriteret për projekt ideor. Fasada e varur është e prezantuar vetëm si mbushje me ngjyrë të kaltër, pa prezantim të asnjë hapjeje (dritare) në te. Emërtimi i kthinave në të shumtën e rasteve është me gabime ose mungon fare. Ka raste kur të gjitha repartet janë të prezantuara me indeksin 1.1. Pjerrinat nuk kanë fare gardh, ndërsa ka rast që pjerrinat janë pjesë e pambyllur me një kthinë tjetër. Gjithashtu, te pjerrinat nuk është prezantuar fare konstruksioni mbajtës i tyre. Hapjet (dyert dhe dritaret) nuk kanë asnjë dimension, që e mundëson vlerësimin real të ndriçimit, ventilimit dhe qasjes në kthinë. Në disa raste janë paraqitur disa dhoma pa dritare dhe dyer (Reparti A3, pika 7.4: 7 dhoma pa dritare dhe 1 dhomë pa derë fare) Megjithatë të metat e jashtëzakonshme në paraqitjen grafike të projektit, juria e ka vlerësuar me notën maksimale prej të gjithë konkurrentëve dhe kjo e vërteton skajshmërisht qasjen favorizuese të jurisë ndaj projektit të OE 9090. Në vazhdim janë paraqitur argumentet rreth të metave në

organizimin e objekteve: ISSH 1PORTA.”

Pretendimi i nëntë (IX): “Operatori Ekonomik 9090 nuk ka prezantuar fare projekt për portën hyrëse, në të cilën duhet të përfshihen zyre për roje, zyre e pritjes dhe tualeti. Sipas detyrës projektuese të konkursit kërkohen disa specifika të cilat janë të bashkangjitura në ankesë.”

Pretendimi i dhjetë (X): “2.6 Zyra e kryeinfermierit dhe 2.7 Zyra e udhëheqësit të shërbimit social - kanë vetëm ndriçim indirekt nga atriumi.”

Pretendimi i njëmbëdhjetë (XI): “2.12 Tualete (Meshkuj + Femra) + hendikep - janë projektuar në mospajtim me standardet për këtë grupacion përmbajtjesor, pasi që janë projektuar me qasje-dyer direkt në korridorin qendrorë, ndërsa standardi i projektimit të tyre është me 2-3 dyer prej WC deri në korridorin qendror (për izolim të erës, zhurmës, etj.)”

Pretendimi i dymbëdhjetë (XII): “3.6 Dhomë te veçanti për përkujdesje me dy shtretër ne banjo dhe WC brendësi (në raste të epidemive dhe sëmundjeve infektive) e që kërkohet trajtim i veçante - nuk është respektuar detyra projektuese, sepse mungon banjoja.”

Pretendimi i trembëdhjetë (XIII): “3.10 Tualete meshkuj dhe femra - janë projektuar në mospajtim me standardet për këtë grupacion përmbajtjesor, pasi që janë projektuar me qasje-dyer direkt në korridorin qendrorë, ndërsa standardi i projektimit të tyre është me 2-3 dyer prej WC deri në korridorin qendror (për izolim të erës, zhurmës, etj.). “

Pretendimi i katërbëdhjetë (XIV): “4.4 Banjo për nevojat e fizioterapisë (me WC për hidroterapi) - Mungon tërësisht pjesa e hidroterapisë.”

Pretendimi i pesëmbëdhjetë (XV): “4.6 Dhoma e pritjes për vizitorët 6 persona - Është e projektuar pa ndriçim natyrorë.”

Pretendimi i gjashtëmbëdhjetë (XVI): “4.10 Tualete (Meshkuj + Femra) + hendikep - janë projektuar në mospajtim me standardet për këtë grupacion përmbajtjesor, pasi që janë projektuar me qasje-dyer direkt në korridorin qendrorë, ndërsa standardi i projektimit të tyre është me 2- 3 dyer prej WC deri në korridorin qendror (për izolim të erës, zhurmës, etj.)”

Pretendimi i shtatëmbëdhjetë (XVII): “Rubrika 5.1 Dhoma e infermiereve (Ambollajita e repartit) - Ambulanta e repartit është e projektuar jashtë kërkesave dhe kritereve të funksionimit të një ambulante, pasi që është organizuar sikurse administratë dhe jo në funksion të një ordinance për kontrollë mjekësore.”

Pretendimi i tetëmbëdhjetë (XVIII): “Rubrika 5.4 Dhoma gjumi njëshe 3.3x3 - Kufizimi i dimensioneve të dhomave të gjumit për rezidentë nuk është respektuar në të gjitha rastet, pasi që në secilin repart është nga një dhomë me dimensione tjera.”

Pretendimi i nëntëmbëdhjetë (XIX): “5.6 Banjo për resident + 1 për hendikep - ky grupacion është projektuar me gabime të shumëfishta. Fillimisht janë projektuar në mospajtim me standardet për këtë grupacion përmbajtjesor, pasi që janë projektuar me qasje-dyer direkte në korridorin qendror, ndërsa standardi i projektimit të tyre është me 2-3 dyer prej WC deri në korridorin qendror (për izolim të erës, zhurmës, etj.). E meta më e madhe në këtë rast është projektimi i banjove me dy palë dyer, ku njëra derë hapet në korridorin qendror, ndërsa dera tjetër në hapësirën për gardërobën e rezidentëve. Ky rast përbën gabim dhe pamundësi funksionimi të përhershëm të banjove.”

Pretendimi i njëzetë (XX) : “5.7 WC për rezident + 1 për hendikep - janë projektuar në mospajtim me standardet për këtë grupacion përmbajtjesor, pasi që janë projektuar me qasje dyer direkt në korridorin qendror, ndërsa standardi i projektimit të tyre është me 2- 3 dyer prej WC deri në korridorin qendror (për izolim të erës, zhurmës, etj.).”

Pretendimi i njëzete e një (XXI) : “Të gjitha gabimet dhe të metat e përmendura në pikat 5.1, 5.4, 5.5, 5.6, 5.10, 5.70 janë të njëjtat edhe në repartin tjetër, respektivisht në pikat 6.1, 6.4, 6.5, 6.6, 6.10 dhe 6.70.”

Pretendimi i njëzetë e dy (XXII): “Operatori Ekonomik 9090 i ka projektuar të katër repartet e rezidentëve (reparti A1, A2, A3 dhe A4) me një pjerrinë, e cila i lidh dy etazha. Kjo paraqet vështirësi të qasjes dhe komunikimit, kur vihet parasysh se rezidentët e këtyre reparteve janë me probleme mentale dhe kanë sjellje të kufizuara. “

Pretendimi i njëzetë e tre (XXIII): “Rubrika 7.1 Dhoma e infermiereve (Ambollanta e repartit) — Ambulanta e repartit është e projektuar jashtë kërkesave dhe kriterëve të funksionimit të një ambulante, pasi që është organizuar sikurse administratë dhe jo në funksion të një ordinance për kontrolla mjekësore.”

Pretendimi i njëzetë e katër (XXIV): “ 7.6 dhe 7.7 Banjo për rezident 1 për hendikep dhe WC për rezident + 1 për hendikep - janë projektuar në mospajtim me standardet për këtë grupacion përmbajtjesor, pasi që janë projektuar me qasje-dyer direkt në korridorin qendror, ndërsa standardi i projektimit të tyre është me 2-3 dyer prej WC deri në korridorin qendror (për izolim të erës, zhurmës, etj.), ndërsa banjo për rezident nuk i plotëson kërkesat funksionale, sepse organizimi i saj është në forme të gabuar.”

Pretendimi i njëzetë e pesë (XXV): “Operatori Ekonomik 9090 ka bërë prezantim grafik me shumë gabime në Repartin A4, pasi që të gjitha kthinat i ka emërtuar me shifrat 6.1, 6.2,.... (sikurse të repartit A2). Pastaj, disa kthina janë nën të njëjtën shifrën që nuk kuptohet se cila prej tyre është, etj.”

Pretendimi i njëzetë e gjashtë (XXVI): “Operatori Ekonomik 9090 ka bërë prezantim grafik të gabuar, pasi që dy kthinat e rubrikës 8.1 Dhoma e infermiereve (Ambollanta e repartit) dhe 8.2 Dhoma e stafit mbështetës janë prezantuar si 6.1 dhe nuk kuptohet destinimi i asnjërës (nuk është e qartë as se si i ka dalluar juria). Gjithashtu, të dy kthinat janë organizuar gabimisht sikur administratë.”

Pretendimi i njëzetë e shtatë (XXVII): “Operatori Ekonomik 9090 i ka organizuar hapësirat në kundërshtim me kërkesat e detyrës projektuese për projektim me mundësi minimale të vetëlëndimit, pasi që organizimi i kthinave është me formë dhe kënde shumë të papërshtatshme dhe ofron mundësi të fshehjes të sëmurëve nëpër kënde, lëndimit të tyre, etj.”

Pretendimi i njëzetë e tetë (XXVIII): “Kthinat 9.1 Zyre për udhëheqësin e shërbimit të kuzhinës dhe 9.2 Dhoma për stafin e kuzhinës se paku 6 persona - janë të paraqitura me organizim me të meta dhe paraqitje të mangët grafike. Kthina 9.1 e ka hapjen e derës gabimisht, ndërsa kthina 9.2 nuk ka derë fare.”

Pretendimi i njëzetë e nëntë (XXIX): “Kthina 9.6 Hapësira e vendosjen e bukës-kjo kthinë mungon krejtësisht në projekt.”

Pretendimi i tridhjetë (XXX): “Kthina 9.7 Hapësira për frigoriferin shtëpizë (komores) - është organizuar në formë me dimensione të papërshtatshme dhe me pamundësi të vendosjes së frigoriferit shtëpizë. Gjithashtu, ndriçimi natyrorë në këtë rast është i panevojshëm.”

Pretendimi i tridhjetë e një (XXXI): “9.10 Tualete meshkuj femra janë projektuar në mospajtim me standardet për këtë grupacion përmbajtjesor, pasi që janë projektuar me qasje-dyer direkt në korridorin qendror, ndërsa standardi i projektimit të tyre është me 2-3 dyer prej WC deri në korridorin qendror (për izolim të erës, zhurmës, etj.).”

Pretendimi i tridhjetë e dy (XXXII): “Kthina 10.1 Trapezaria - Hapësirë për tavolina dhe ulëse për 60 persona + hapësirë për ulëse dhe tavolina për 30 persona e ndare me gjama lëvizës në raste të organizimeve për evente me qasje të përbashkët — hapësira e ndarë me xhama lëvizës për evente është jofunksionale, pasi që është e vendosur në atrium, nën pjerrinë, me lartësi të reduktuar dhe me tavolina të shpërndara joracionalisht. Gjithashtu, pjesa e ndarjes me xhama lëvizës dhe një dere dykrahëshe të prezantuar jashtë xhamave lëvizës, sipas prezantimit është e pa-ekzekutueshme. Gjithashtu, furnizimi i kuzhinës së restorantit nga depot është shumë i papërshtatshëm, sepse duhet të defilohet nëpër korridorin qendror dhe të përzihet furnizimi me rezidentët.”

Pretendimi i tridhjetë e tre (XXXIII): “10.7 Tualete (m+f) + WC për handikap - janë projektuar në mospajtim me standardet për këtë grupacion përmbajtjesor, pasi që janë projektuar me qasje dyer direkte në restorant, ndërsa standardi i projektimit të tyre është me 2-3 dyer prej WC deri në korridorin qendror apo në rastin konkret në restorant (për izolim të erës, zhurmës, etj.).”

Pretendimi i tridhjetë e katër (XXXIV): “12.10 Hapësira për vendosjen e kaldajës së ngrohjes + Lënda e ngurtë djegëse - oxhaku i vendosur në kthinën e kaldatores në përdhese, në nivelin e përdhesisë del në derë të kthinës 2.5 (zyra e udhëheqësit të shërbimit shëndetësor).”

Pretendimi i tridhjetë e pesë (XXXV): “Organizimi i këtij sektori është tërësisht i paqartë, sepse emërtimet e kthinave nuk janë respektuar sikurse është kërkesa në detyrën projektuese (disa kthina kanë emërtime të njëjta). Kjo e bën të pamundshme edhe vlerësimin nga ana e jurisë.”

Pretendimi i tridhjetë e gjashtë (XXXVI): “14.1 Deponia e mbeturinave - me anë të detyrës projektuese kërkohet që kjo kthinë të vendoset në ambientin e jashtëm, ndërsa sipas propozimit teknik të OE 9090 është vendosur në suterren..”

Pretendimi i tridhjetë e shtatë (XXVII): “14.2 Deponi për pasije dhe inventar të dëmtuar - me anë të detyrës projektuese kërkohet që kjo kthinë të vendoset në ambientin e jashtëm, ndërsa sipas propozimit teknik të OE 9090 është vendosur në suterren.”

Pretendimi i tridhjetë e tetë (XXVIII): “14.6 Garazh për 4 automjete - me anë të detyrës projektuese kërkohet që këto garazha të vendosen në ambientin e jashtëm, ndërsa sipas propozimit teknik të OE 9090 janë vendosur në suterren.”

Pretendimi i tridhjetë e nëntë (XXXIX): “14.7 Ulëse të kopshtit të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara - mungojnë tërësisht në propozimin Teknik të OE 9090.

Pretendimi i katër dhjetë (XL): “14.9 Vendosja e paneleve solare në objekte - vendosja e paneleve solare në kulme të objekteve është bërë në mënyrë joracionale, pasi që është shfrytëzuar minimalisht mundësia e vendosjes së këtyre paneleve, konform kërkesave të

objekteve.”

Pretendimi i katër dhjetë e një (XLI): “14.10 Rezervar të ujit me kapacitet deri në 10,000 litra, 2 copë në rastet e reduktimeve apo ndërprerjeve të ujës-jellësit të qytetit - me anë të detyrës projektuese kërkohet që kjo kthinë të vendoset në ambientin e jashtëm, ndërsa sipas propozimit teknik të OE 9090 është vendosur në suterren.”

Pretendimi i katër dhjetë e dy (XLII): “14.12 Ndriçimi i hapësirave të ambientit të jashtëm me mënyrë automatike - pozicioni i ndriçimit të jashtëm mungon tërësisht.”

Pretendimi i katër dhjetë e tre (XLIII): “14.16 Staza për shëtitje në të gjitha hapësirat gjelbëruese me ulëse për pushim - mungojnë stazat e shëtitjes, si dhe staza përgjatë rrethojës së parcelës. Gjithashtu, mungojnë edhe ulëset për pushim. Qirskp e Repartet dhe Hapësirat Përcjellëse.”

Pretendimi i katër dhjetë e katër (XLIV): “Operatori Ekonomik 9090 ka bërë organizim joracional të reparteve. Sipërfaqja e kërkuar për repart është 500 m<sup>2</sup>, ndërsa sipas propozimit teknik të OE 9090 është 560 m<sup>2</sup>. Edhe pse ka tejkalim të sipërfaqeve, pjesa dërrmuese e kësaj sipërfaqe është e humbur (rreth 260 m<sup>2</sup> të humbura). Qëndrimi ditorë i repartit është rreth 60 m<sup>2</sup>, që është shumë i vogël (qëndrimi i repartit të propozimi i projektit tonë - OE 0811 - është rreth 220 m<sup>2</sup>), kur merret parasysh sipërfaqja e humbur e repartit (rreth 260 m<sup>2</sup>). Këndi i leximit në kuadër të qëndrimit ditorë është tërësisht jofunksional.”

Pretendimi i katër dhjetë e pestë (XLV): “Operatori Ekonomik 9090 i ka emërtuar të gjitha repartet (Reparti 1, 2, 3, 4 dhe 5), përfshirë edhe Njësinë Integruese me shifrën 1.1, me ç ‘rast vështirësohet leximi dhe vlerësimi i kërkesave për secilin repart.”

Pretendimi i katër dhjetë e gjashtë (XLVI): “Operatori Ekonomik 9090 ka bërë organizim joracional të hyrjes në objekt, në nivelin e përdhesis, pasi që mungon erë mbrojtësi. Mungesa e erë mbrojtësit në objekt ka ndikime të konsiderueshme në eficiencën e objektit dhe trashëgon pasojat të vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe mbarëvajtjen e objektit.”

Pretendimi i katër dhjetë e shtatë (XLVII): “Operatori Ekonomik 9090 e ka vendosur dhomën e vizitave në kuadër të përdhesis së QISKP-së, në kundërshtim me kërkesën nga detyra projektuese, që kjo kthinë, së bashku me tualet, të vendoset te Porta. Gjithashtu, e njëjta nuk posedon as ndriçim natyrorë.”

Pretendimi i katër dhjetë e tetë (XLVIII): “1.3 Dhoma të veçanta për trajtimin e pacientëve me sëmundje transmissive - kjo dhomë ka një organizim jofunksional dhe të rrezikshëm për pacientin, pasi në pjesën ku është vendosur shtrati i pacientit, është vendosur edhe shtylla e konstrukcionit mbajtës. Gjithashtu, është shtuar edhe sipërfaqja e këtyre dhomave, nga 80 m<sup>2</sup> sa kërkohet me detyrë projektuese, në lodo m<sup>2</sup>.”

Pretendimi i katër dhjetë e nëntë (XLIX): “1.7 Dhoma e mjekëve - është organizuar joracionalisht, me shtyllë në tavolinë dhe e organizuar në trajtë të administratës. Kjo dhomë shërben për pushim të mjekëve dhe duhet të organizohet me orendi për pushim.”

Pretendimi i pesëdhjetë (L): “1.12 Barnatorja - në kuadër të barnatores, në prezantimin grafik janë vendosur edhe disa elemente të sanitarisë, respektivisht guacë e WC-së dhe lavaman.”

Pretendimi i pesëdhjetë e një (LI): “1.17 Banjot dhe WC për infermier (për femra dhe meshkuj) - janë projektuar në mospajtim me standardet për këtë grupacion përmbajtjesor, pasi që janë



projektuar me qasje-dyer direkte në korridorin qendrore, ndërsa standardi i projektimit të tyre është me 2-3 dyer prej WC deri në korridorin qendror (për izolim të erës, zhurmës, etj).”

Pretendimi i pesëdhjetë e dy (LII): “1.19 Njësia rehabilituese vokacionale me kapacitet për 10 pacient — mungon tërësisht definimi i njësisë rehabilituese vokacionale. Në kuadër të përdhësës, është një sektor me shifrën 2.5 (që sipas detyrës projektuese është: Zyra e financave e përbashkët ku duhet të punojnë ZKF, zyrtari certifikues, zyrtari shpenzues, zyrtari pranues, zyrtari zotues dhe zyrtari i prokurimit), mirëpo i njëjti organizim me shifrën 2.5 është edhe në suterren. Nëse supozohet që kjo është njësia rehabilituese vokacionale, atëherë organizimi dhe përmbajtjet e saj janë gabim dhe jo në harmoni me kërkesat dhe standardet për këto njësi. Megjithatë këtë mungesë dhe konfuzion në projekt, është e pashpjegueshme se si juria e ka identifikuar njësinë rehabilituese vokacionale dhe e ka vlerësuar pozitivisht.”

Pretendimi i pesëdhjetë e tre (LIII): “Argumenti 53:1.20 Pajisjet e fitnesit dhe pajisjet tjera rekreative - kthina e fitnesit është më e madhe se sa është kërkuar me detyrën projektuese, nga 40 m<sup>2</sup> në 56 m<sup>2</sup>. Gjithashtu, kjo kthinë është e hapur tërësisht nga pjesa e pjerrinave.”

Pretendimi i pesëdhjetë e katër (LIV): “1.22 Kantina për pacient (menaxhuar nga shërbimi social I institutit) - kantina është e organizuar joracionalisht, me pozitë të pavolitshme, ku për të shkuar rezidentët deri te kantina, duhet të kalojnë nëpër tërë korridorin me dhoma të profesionistëve ose nëpër korridorin me dhoma të hospitalizimit. Sipërfaqja e kantinës është shtuar, nga 60 m<sup>2</sup> sipas detyrës projektuese, në 74 m<sup>2</sup> në projekt. Gjithashtu, edhe organizimi i konstruksionit e mundëson vetëlëndimin e rezidentëve, pasi që 3 shtylla janë në mes të hapësirës së kantinës dhe orendive (njëra shtyllë nuk është prezantuar fare).”

Pretendimi i pesëdhjetë e pestë (LV): “2.9 Banjat dhe WC për administratë - sipas detyrës projektuese kërkohej banja dhe WC për administratë, ndërsa në projekt janë propozuar vetëm WC, ku WC për handicap ka derë direkt në korridor.”

Pretendimi i pesëdhjetë e gjashtë (LVI): “3.4 (Salla për riparimin e materialit teknik (punëtorja)), 3.5 (Depo e materialit Teknik) dhe 3.6 (Depo për vendosjen e materialit të riparuar) - depo e materialit Teknik është vendosur shumë larg nga salla për riparim dhe depo për vendosjen e materialit të riparuar. Këto 3 salla duhet të vendosen ngjitur njëra tjetrës dhe të kenë qasje direkt mes vete, për të funksionuar mirë në raport me kërkesat e tyre.”

Pretendimi i pesëdhjetë e shtatë (LVII): “3.11 depo e mbeturinave (kontinierat në ambientin e jashtëm) - kjo depo mungon tërësisht.”

Pretendimi i pesëdhjetë e tetë (LVIII): “Argumenti 58: 4.1 (Kuzhina qendrore me kapacitet për 60 persona), 4.4 (Depo për vendosjen e ushqimit të thatë), 4.5 (Depo për vendosjen e ushqimit të lëngshëm (frigorifer I madh), 4.6 (Depo për vendosjen e frigoriferëve për produktet e mishit) dhe 4.7 (Depo për vendosjen e pemëve dhe perimeve) - janë të paorganizuara.”

Pretendimi i pesëdhjetë e nëntë (LXIX): “Pozita e lavanderisë është shumë e papërshtatshme dhe vështirë e qasshme për të 6 repartet. Sidomos reparti në suterrenin 2, i cili nuk ka qasje direkt, por materialet për larje dhe ndërresa duhet të barten nga stafi nëpër pjerrinat e rezidentëve, në distancë prej 200 metrash. Një organizim i tillë e bën gati se të pamundshëm funksionimin e përditshëm të lavanderisë.”

Pretendimi i gjashtëdhjetë (XL): “5.1 Hapësira për vendosjen e tri makinave industriale larëse me kapacitet 25 kg dhe tri makinave tharëse industriale me kapacitet 25 kg (Të merret parasysh se makinat larëse dhe tharëse duhet të vendosen përball njëra tjetrës në distancë 1,5 m, këto hapësira duhet të jenë të ndriçuara mjaftueshëm dhe duhet të kenë ventilim permanent për shkak të lirimit të vazhdueshëm të materieve toksike.) - nuk është respektuar aspak kërkesa e detyrës projektuese, pasi që nuk janë vendosur makinat industriale larëse dhe makinat industriale tharëse në të njëjtën kthinë dhe përballë njëra tjetrës. Gjithashtu, edhe ndriçimi dhe ventilimi natyrorë është i pamjaftueshëm dhe nuk i përmbush kërkesat e detyrës projektuese. Në anën tjetër, i tërë sektori ka prezantim shumë të dobët grafik dhe në këtë mënyrë pamundësohet leximi i saktë i funksioneve të kthinave.”

Pretendimi i gjashtëdhjetë e një (XLI): “5.4 Hapësira për vendosjen e makinës hekurose për qarqafa - kjo hapësirë mungon tërësisht.”

Pretendimi i gjashtëdhjetë e dytë (XLII): “Në katin e parë (kati 1), ngjitur me kthinën e shkallëve është prezantuar edhe një kthinë e bashkëngjitur, me sipërfaqe prej 80 m<sup>2</sup>, e cila nuk përkon me asnjë prej kërkesave të detyrës projektuese dhe nuk e ka asnjë emërtim apo shpjegim. Kthinat e tilla paraqesin humbje direkt të hapësirave, krijim të kostove të panevojshme, kosto të mirëmbajtjes etj.”

Pretendimi i gjashtëdhjetë e tretë (XLIII): “Kati i parë, në të cilin është organizuar vetëm një repart, është kat i paarsyeshëm ekonomikisht, pasi që nuk arsyetohet kostoja e ndërtimit dhe mirëmbajtjes, sepse funksioni i ofruar është minimal. Kjo pasi që prej rreth 908 m<sup>2</sup> të sipërfaqes bruto të tij, shfrytëzohen rreth 296 m<sup>2</sup> me vetëm 1 dhoma me 1 qëndrim ditorë, ndërsa sipërfaqja prej rreth 612 m<sup>2</sup> është komunikim. Ngjashëm me këtë është edhe suterreni -2, i cili funksionon si përmbajtje e ndarë, me një repart, që krijon kosto të ndërtimit, mirëmbajtjes, lidhjes me pjesën tjetër të objektit, etj.”

Pretendimi i gjashtëdhjetë e katër (XLIV): “64: 5.1 Barbique për 30 persona - kjo hapësirë mungon tërësisht.”

Pretendimi i gjashtëdhjetë e pestë (XLV): “5.4 Mini amfiteatri - 60 persona - kjo hapësirë mungon tërësisht.”

Pretendimi i gjashtëdhjetë e gjashtë (XLVI): “5.9 Ujëvara me mini lumin artificialë me gjatësi rreth 20-30 m, për rehabilitim - mungon tërësisht.”

Pretendimi i gjashtëdhjetë e shtatë (XLVII): “5.10 Puset e burimeve të ujit me kapacitet deri në 10,000 litra , 2-3 copë në rastet e reduktimeve apo ndërprerjeve të ujësjes të qytetit - mungojnë tërësisht. Në anën tjetër, të gjitha këto argumente rreth të metave të projektit të OE 9090, në propozimin e ofruar nga ne (OE 0811) janë trajtuar në përputhje të plotë me kërkesat e Detyrës projektuese të ofruar nga Autoriteti Kontraktues dhe në përputhje të plotë me normat dhe standardet për këtë lloj të objekteve. Bazuar në faktet e lartpërmendura si dhe rezultatit e shpallur në Njoftimin mbi vendimin e AK-se mbi rezultatet e konkursit, pretendojmë se Juria profesionale gjatë vlerësimit dhe poenimit është treguar subjektive në vlerësim dhe favorizuese ndaj OE; me kodin 9090 dhe se projekti me Kodin (shifrën) 0811 i plotëson të gjitha kërkesat dhe është meritues për projekt zbatues.”

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 7, 56, 59, 80 të LPP-së si dhe nenin 55 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik. Kërkojmë nga OShP që të merr Vendim që të Aprovoj, Ankesën e OE: me Kodin 0811, si të bazuar, të Anuloj, Njoftimin mbi Vendimin e AK-se mbi rezultatin e Konkursit të projektimit të datës 19.01.2024, ku është vlerësuar OE me Kodin 9090 me numrin me të madh të pikëve prej 77.01 të kthej konkursin në rivlerësim, dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret për dhënie kontratës dhe kriteret e përzgjedhjes të cilat janë të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit në pajtim me LPP-ne, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik. Mbetemi me shpresë se ankesa e jonë do të aprovohet.

2. Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimin Ankimore I kemi shqyrtuar pretendimet ankimore të Kërkesës tuaj për Rishqyrtim dhe i kundërshtojmë si të pa bazuara. Projektet janë vlerësuar nga Juria Profesionale e caktuar me Vendim të ZKA-se, në përputhje me nenin 80 të LPP-se. Juria ka qene në përbërje prej tre inxhinierëve të Arkitekturës. Vlerësimin e projekteve e konsiderojmë si profesional dhe përzgjedhja e projekteve nga juria është mandatorë për AK-MSh. Arsyetimet me të detajuara rreth pretendimeve tuaja i gjeni në vijim të dhëna nga juria vlerësuese: Përgjigja për “Pretendimi 1”: Në si komision vlerësuese profesionale dhe operatorët ekonomik që kanë marr pjesë në këtë konkurs të projektimit, nuk e kanë caktuar terrenin dhe lokacionin, lokacioni bashkë me matjet gjeodezike dhe detyrën projektuese janë dhënë nga AK Ministria e Shëndetësisë, andaj nuk na mbetet neve që të vlerësojmë se a është lokacioni apo terreni i përzgjedhur i përshtatshëm. Sa i përket komentit tuaj ku thuhet se "OE me kodin 9090 i ka pozicionuar objektet në të kundërtën e terrenit..." ky koment i juaji nuk qëndron fare, pasi që ky OE shifet që ka bërë një shtrirje të përshtatshme të objekteve duke e shfrytëzuar terrenin në mënyrë racionale, të duhur dhe duke i shpërndarë hapësirat në etazhe të ndryshme kështu objektet në prerje kanë formën “kaskadë” ku ka përdorur suterene në mënyrë që të përshtatet sa më mirë me terrenin ekzistues. Komenti juaj që disniveli i parcel është 30m qëndron, mirëpo nëse e shikoni projektin 9090, ky OE ka krijuar 2 parcela (ashtu siç kërkohet në detyrë) dhe nga kjo del që brenda një parcela disniveli është rreth 15-20 m dhe ajo e llogaritur si diagonale dhe jo 30m. Tek objekti i ISSH dhe QIRSKP të OE 9090, ju keni thënë se "objekti qëndron komplet mbi toke", ky koment nuk qëndron aspak, pasi që nëse i shohim prerjet e objekteve në fjale e shohim se OE ka krijuar “kaskada” për të minimizuar heqjen dhe mbushjen e dheut, ndërsa është krejt në rregull, dhe e pa evitueshme që në terrene të pjerrëta të këtë rregullinë të terrenit (gërmime në njërin anë dhe mbushje në anën tjetër të terrenit), gjithashtu këto mbushje mund të bëhen me materiale mbushës dhe është krejt normale dhe e pranueshme sipas çdo standardi teknik. Nuk kërkohet ndonjë kosto ekstra aspak, pasi me mbushje dhe pjerrina të terrenit mund të arrihen ato dhe nuk ka nevojë për pilota apo gjera të tilla, aq me pak në këtë fazë të projekteve idore, logjika e përdorur dhe zgjidhja funksionale në këtë projekt me kodin 9090 kanë qene shume të mire andaj asnjë nga komentet në “Pretendimi 1” nuk qëndrojnë dhe janë të pa baza.

Përgjigja për “Pretendimi 2”: Në projektin me kodin 9090 shohim që hyrjet janë në të njëjtin vend dhe të ndara, të dy hyrjet si ajo e ISSH dhe QIRSKP janë në anën jugore të parcelës, pra nga rruga ekzistuese, gjë e cila është shume e logjikshme dhe e pranueshme. Në detyrën projektuese nuk thuhet që duhet të ketë një hyrje ose objektet të kenë hyrje të njëjtë siç thotë pretendon OE ankues, ndërsa komentit për aspektin funksional të kompleksit është krejt i pa baze, andaj “Pretendimi 2” është i pa baze dhe nuk qëndron.

Përgjigjja për “Pretendimi 3”:

Objekti i ISSH dhe QIRSKP janë 2 objekte te ndryshme dhe kanë destinime te ndryshme te cilat ne rastin tone ndajnë te “njëjtën parcele” mirëpo nuk janë një objekt i përbashkët, edhe ajo parcele sipas detyrës projektuese është dashur te ndahet ne raport te përafërt 50:50. Nëse e shohim detyrën projektuese Kapitullin VI “Qëllimi i Ndërtimit - Dy objekte shëndetësorë (Instituti Special Shtime (ISSH) dhe Qendra Rehabilituese e te Sëmurave kronik Psikik ne Shtime (QIRSKP)” kërkohet qe te jene 2 objekte qe nënkupton 2 objekte te ndara, po ashtu tek Kapitulli "Funksioni dhe organizimi" tregohet shume qartë qe objektet ne mes vete duhet te kenë ndarje fizike "...rrethoje te pa kalueshme nga këmbësoret..", ndërsa ndërlidhja e këtyre 2 objekteve ISSH dhe QIRSKP ne projektin e OE me kodin 9090 është me e mire qe kemi pare ne këtë konkurs projektimi, nëse shohim formën e tyre ne situacion, dhe 3D shohim qe është bere një ndërlidhje shume e mire arkitektonike dhe funksionale, andaj komentet për “Pretendimi 3” janë komplet te pa baza.

Përgjigjja për “Pretendimi 4”:

Ne këtë faze te projektit (projekti ideor) nuk mund te vërtetojmë me saktësi hapësirat e brendshme ne projekt, ato do te mirren parasysh dhe do te vërtetohen ne projektin kryesor andaj nuk mund te mirret parasysh komenti se “pjesa grafike me tabelat kanë mospërputhje”, ajo qe është me rëndësi është funksionaliteti i zgjidhjes dhe përmbushja e detyrës projektuese gjë te cilën e ka plotësuar OE me kodin 9090. Sa i përket sipërfaqes se objekteve, nëse e lexojmë dhe e shohim detyrën projektuese e shohim qe ne detyrën projektuese nuk janë te dhëna sipërfaqet maksimale dhe nuk është caktuar ndonjë vlere investive, andaj te gjithë OE nuk kanë pasur ndonjë kufizim sa i përket sipërfaqes apo vlerës investive, projekti me shifrën 9090 i është përmbajte detyrës projektuese ne përpikëri dhe ka bere zgjidhje funksionale shume te favorshme, shpërdorim i parasë publike është edhe ndërtimi i një projekti te keq dhe jo funksional, andaj komentet për “Pretendimi 4” janë krejtësisht te pa baza.

Përgjigjja për “Pretendimi 5”:

Ne detyrën projektuese nuk është dhënë ndonjë udhëzim për sistemin konstruktiv te objekteve, sistemi dhe zgjidhja konstruktive e projektit është zgjedhje e Operatoreve Ekonomik, ne projektin e OE me kodin 9090 shohim qe ka një logjike te vendosjes se konstruksionit dhe rasterave, pikërisht ajo qe ka nevojë te jete ne një projekt ideor, nuk mund te flitet dhe te vlerësohet ne një projekt ideor për fugen dilatuese, është diçka e pa përfillshme, askush nuk mund te vlerësoje ne këtë faze nëse projekti është i qëndrueshëm ne aspektin struktural, kjo pjese vërtetohet ne baze te projektit te Strukturës, gjë e cila kërkohet ne projektin kryesor. Ne projektin e kodin 9090 nuk shifet te këtë ndonjë shtylle e cila pengon funksionalitetin e hapësirave, ne këtë faze te projektit është e rëndësishme zgjidhja funksionale e hapësirave dhe zgjidhja logjike e konstrukcionit, andaj komentet për “Pretendimi 5” janë te pa përfillshme dhe te pa baza.

Përgjigjja për “Pretendimi 6”:

Projekti me kodin 9090 i është përmbajte detyrës projektuese ne përpikëri, nëse shohim planimetrit e kateve dhe situacionet për te dy objektet ISSH dhe QIRSKP shohim qe ne to janë te paraqitura portat hyrëse, amfiteatri, fushat sportive, serat, rezervari i ujit, barbique, këndi për lojëra, liqeni artificial etj. Andaj nuk po e kuptojmë fare as “pretendimi 6” dhe pretendimet e ankuesit, shifeni mire detyrën projektuese dhe projektin me kodin 9090 dhe do te shohim qe ky operator i është përmbajtur detyrës projektuese, andaj komentet për " Pretendimi 6” janë krejtësisht te pa baze dhe madje qesharake.

Përgjigjja për “Pretendimi 7”:

Ne këtë faze te projektit është e vështirë te kalkulohet sakte distanca e pjerrinave, mirëpo ne baze te dimensioneve te cilat janë te vendosura ne projekt shihet qe këto pjerrina janë te vendosura mire dhe te mjaftueshme, ndërsa sa i përket pushimoreve

përsëri është e papërfillshme të flitet për to në këtë fazë të projektit ideor, megjithatë edhe në qoftë se komenti i juaj dhe “analiza e juaj” për pjerrinat është i saktë, prap del që me këto gjatësi të rampave i plotësojnë standardet e kërkuara, andaj komentet për “Pretendimi 7” janë të pa baza dhe të pa përfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 8”: Sa i përket paraqitjes grafike, pretendimet dhe komentet e palës ankuese janë krejtësisht të papërfillshme, si mund të merret parasysh paraqitja e fasadës së varur e cila në realitet është rreth 10-15 cm, ndërsa projekti ideor është me një përpjesë 1:350, të repartit A3 është një “lëshim” nëse mund të themi pasi në baza nuk janë të paraqitura dritaret mirëpo nëse e shohim 3D dhe fasadat ato hapësira patjetër që kanë hapje, paraqitja grafike e OE me kodin 9090 është shumë e lehtë për tu kuptuar dhe për tu lexuar nga kushdo e aq me shumë nga një juri profesionale, OE me kodin 9090 për secilin objekt dhe secilin kat ka dhënë skemat funksionale 2D dhe 3D dhe pastaj bazat e kateve gjithë që e bënë shumë të lehtë të lexohet, po ashtu pjesët tjera të projektit janë të paraqitura në mënyrën më të mirë të mundshme, andaj komentet e për “Pretendimi 8” janë të pa baza.

Përgjigjja për “Pretendimi 9”: Në projektin e OE me kodin 9090 janë paraqitur në Situacion 2 porta hyrëse për të dy objektet, vendodhja dhe pozicionimi i tyre duket shumë i përshtatshëm dhe funksional, sipërfaqja e tyre duket të jetë në rregull, ndërsa detalet tjetra të saj duhet të paraqiten gjatë projektit kryesor, për neve si juri profesionale ka mjaftuar paraqitja e tyre në situacion dhe pozicionimi i tyre i saktë, andaj komentet për “Pretendimi 9” janë të pa baza.

Përgjigjja për “Pretendimi 10”: Sa i përket 2 zyrave tek pjesa e administratës, Zyra e kryeinfiermit dhe Zyra e udhëheqësit të shërbimit social kanë ndriçim nga pjesa e atriumit që gjithë është krejt normale dhe e pranueshme, atrium nënkupton oborr i brendshëm d.m.th. hapësirë ku futet drita natyrale njësoj sikur se pjesën tjera të oborrit, andaj nuk e di se çka ka pretendu pala ankuese me këtë koment, d.m.th. komentet për “Argumentin 10” janë komplet të papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 11”: Nuk e di se nga i ka marr këto “standarde” pala ankuese, por këto që të pjesa e Administratës tek objekti i ISSH janë komplet të pranueshme dhe funksionale kanë edhe një korridor të zgjeruar para hyrjes në WC, ato tualete do të shërbejnë pjesës së personelit të pjesa e administratës dhe nuk kërkohet ndonjë standard i veçantë për ato tualete, andaj komentet për “Pretendimi 11” janë komplet të papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 12”: Tek pjesa e Ambulantes objekti i ISSH, në Dhomat e veçanta OE me kodin 9090 në planimetri ka prezantuar dhomat e veçanta vetëm me WC dhe kemi konsideruar që këto qeshje të vogla teknike mund të zgjidhen pa asnjë problem në projektin kryesor pasi që dhomat kanë hapësira të mjaftueshme dhe nuk do të ndryshonte asgjë në funksion nëse ato WC behet banjo gjatë projektit kryesor, andaj konsiderojmë që komentet në “Pretendimi 12” janë të pa përfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 13”: Përsëri nuk e di se nga i ka marr këto “standarte” pala ankuese, por këto WC të pjesa e Ambulantes tek objekti i ISSH janë komplet të pranueshme dhe funksionale po ashtu kanë edhe një korridor të zgjeruar para hyrjes në WC, andaj komentet për “Argumentin 13” janë komplet të papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 14”: Në detyrën projektuese kërkohet që në kuadër të fizioterapive dhe pajisjeve tjera të këto banjo dhe tualete, gjithë që projekti me kodin 9090 i ka përmbushur, ato mund të shihen tek planimetria e katit përdhese tek Pika 4.4, andaj komentet për “Argumentin

14" janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 15": Dhoma e pritjes tek pjesa e Terapisë punuese kërkohet ne detyre dhe OE me kodin 9090 e ka paraqitur atë ne një pozite te përshtatshme dhe shume funksionale ku kjo hapësirë ka çasje direkte edhe nga hapësira e hollit edhe nga korridori i Terapisë punuese, nuk kërkohet ne ndonjë standard ose detyre projektuese qe kjo dhome me patjetër te këtë ndriçimi direkt apo diçka te tille, andaj komentet për "Pretendimi 15" janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 16": Përsëri nuk e di se nga i ka marr këto "standarte" pala ankuese, por këto WC te pjesa e Njësia për terapi punuese tek objekti i ISSH janë komplet te pranueshme dhe funksionale kanë edhe një korridor te zgjeruar para hyrjes ne WC, andaj komentet për "Pretendimi 16" janë komplet te papërfillshëm.

Përgjigjja për "Pretendimi 17": Ne detyrën projektuese tek objekti ISSH, Reparti A1 pika 5.1 eshët dhome (12m2) për qëndrimin e Infermiereve për atë repart, funksionalisht këta infermier kujdesen për ata pacient ne atë repart dhe nëse kanë nevojë për ambulante atëherë ata pacient dërgohen ne ambulanten e përbashkët, andaj komentet për " Pretendimi 17" janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 18": Ne secilin repart OE me kodin 9090 i ka përmbushur kërkesat e detyrës projektuese dhe ka prezantuar dhomat njëshe me dimensionet e kërkuara madje ne disa raste ai i ke bere dhomat edhe me te mëdha gjë qe eshët komplet e pranueshme, rendësi ka qe dhomat ti plotësoj kërkesat minimale dhe eshët e rëndësishme qe secila dhome te jete funksionale, andaj komentet për "Pretendimi 18" janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 19": Banjot dhe tualetet ne repartet tek objektet e këtij destinimi siç është ISSH me patjetër duhet te ketë funksion dhe lidhshmëri siç e ka prezantuar OE me kodin 9090 ne projektin e tij, banjot duhet te kenë çasje nga korridori qendror dhe duhet te kenë lidhje direkt me garderobat, kjo zgjidhje funksionale është ideale duke mare parasysh shfrytëzuesit dhe destinimin e objektit, andaj komentet për "Pretendimi 19" janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 20": Përsëri nuk e di se nga i ka marr këto "standarte" pala ankuese, por këto WC te pjesa e Reparteve tek objekti i ISSH janë komplet te pranueshme dhe funksionale, andaj komentet për "Argumentin 20" janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 21" Edhe ne këtë pike vlen përgjigjja e njëjtë si me sipër!

Përgjigjja për "Pretendimi 22" OE me kodin 9090 ka bere zgjidhjen e reparteve ne mënyrën me te mire te mundshme dhe ka respektuar detyrën projektues ku thotë se "Lidhja e kateve të objekteve, zona e frekuentimit nga rezidentet duhet të behet me pjerrina dhe jo me shkallë..." andaj komentet për "Pretendimi 22" janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 23": Ne detyrën projektuese tek objekti ISSH, Reparti A3 pika 7.1 është dhome (12m2) për qëndrimin e Infermiereve për atë repart, funksionalisht këta infermier kujdesen për ata pacient ne atë repart dhe nëse kanë nevojë për ambulante atëherë atë pacient dërgohen ne ambulanten e përbashkët, andaj komentet për "Argumentin 23" janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 24" Edhe ne këtë pike vlen përgjigjja e njëjtë si ne "Pretendimi 19"

Përgjigjja për “Pretendimi 25” Projekti me kodin 9090 i ka te paraqitura te gjitha kthinat e kërkuara ne detyrën projektuese, mund te këtë ndonjë lëshim ne paraqitjen teknike mirëpo e rëndësishme është respektimi i detyrës projektuese dhe funksionaliteti i tyre, andaj komentet për “Argumentin 25” janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 26”: Edhe ne këtë pike vlen përgjigjja e njëjti si me sipër!

Përgjigjja për “Pretendimi 27” Projekti me kodin 9090 ka bere zgjidhjen me te mire te reparteve ne aspektin funksional dhe ka krijuar hapësira qe lehtë kontrollohen dhe hapësira qe lidhen njëra me tjetrën, trajtimi i këndeve dhe realizimi i tyre normal qe mbetet për trajtim ne fazën e projektit kryesor, andaj komentet për “Pretendimi 27” janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 28” Ne këtë faze te projektit mund te këtë lëshime teknike te cilat nuk ndikojnë aspak ne projektin ideor dhe vlerësimin e tij, po e përsëris qe ne këtë faze te projektit eshët e rëndësishme qe projekti ti përmbahet detyrës dhe standardeve te projektimit, te këtë zgjidhje te mire funksionale, lidhshmëri ne mes kthinave dhe hapësirave, te këtë logjike te pranueshme ne vendosjen e konstruksionit, te çasje moderne ne projekt, andaj komentet për “Argumentin 28” janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 29”: Edhe ne këtë pike vlen përgjigjja e njëjti si me sipër!

Përgjigjja për “Pretendimi 30”: Projekti me kodin 9090 ka bere zgjidhje shume te mire te kuzhinës, edhe hapësira për frigorifer (komora) eshët paraqitur ne mënyrë adekuate, komora ne kuzhina te mëdha është një kthine e izoluar d.m.th. një dhome frigorifer ku lihen gjerat qe kanë nevojë , andaj komentet për “Pretendimi 30” janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 31”Perseri nuk e di se nga i ka marr këto “standarte” pala ankuese, por këto WC te pjesa e kuzhinës janë komplet te pranueshme dhe funksionale, andaj komentet për “Pretendimi 31” janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 32”: Kuzhina ka hyrje direkte nga pjesa e jashtme dhe furnizimi i saj mund te behet shume lehtë dhe ne mënyre te përshtatshme, pastaj edhe tryeazia edhe e lidhur direkt me kuzhinën, mënyra se si dhe ku vendosen tavolinat është komplet zgjedhje e projektuesit rendis ka te jete funksionale, andaj komentet për “Pretendimi 32” janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 33”: Përsëri nuk e di se nga i ka marr këto “standarde” pala ankuese, por këto WC janë komplet te pranueshme dhe shume funksionale, andaj komentet për "Argumentin 33" janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 34” Hapësira e kaldatares ka dimensionet adekuate, hyrjen adekuate nga ana e jashtë, ne baze te projektit kjo hapësira është lënë po thujse e “pa mobiluar” ne te është vendosur vetëm një katror i cili me shume gjësë është padisje mirëpo asesi “oxhak” siç pretendon ankuesi, ky është projekt ideor qe d.m.th. nuk ka projekt kryesor për fazat e elektrikes, makinerisë etj., , andaj komentet për " Pretendimi 34” janë komplet te papërfillshme dhe te pa baza.

Përgjigjja për “Pretendimi 35” Ne këtë faze te projektit mund te këtë lëshime teknike si ne këtë rast përshkrimi i nr. për kthinat, OE 9090 ka përmbushur detyrën projektuese dhe ka paraqitur te

gjitha kthinat e kërkuara ne projekt dhe lidhja e këtyre kthina mes vete është shume e mire dhe e lehtë për tu lexuar edhe nëse ka lëshime te vogla teknike, andaj komentet për " Pretendimi 35" janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 36": Nëse e shikojmë projektin me kodin 9090 ne planimetrit e kateve dhe situacionin e shohim qe projektuesi ne fjale ka bere një propozim ideal për vendosjen e deponis se mbeturinave, ai i ka "mshefur" ato duke shfrytëzuar pjerrinën e terrenit dhe duke lenë qasje vetëm për personelin, automjetin i cili i nxjerr mbeturinat jashtë, ne asnjë mënyrë ne objekte te tilla me destinim te tillë nuk mund te lihen mbeturinat te hapura dhe te pa kontrolluara, pra ky OE ka bere zgjidhjen ideale për mbeturinat dhe kthina tjetra teknike te cilat kërkohen ne detyrën projektuese, asesni nuk mund te vendosim deponi te hapura për mbeturinat e as për inventarit, andaj komentet për "Pretendimi 36" janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 37" Edhe ne ketë pike vlen përgjigjja e njëjti si ne përgjigjen për " Pretendimi 36"

Përgjigjja për "Pretendimi 38" Edhe ne këtë pike vlen përgjigjja e njëjtë si ne përgjigjen për "Argumenti 36"

Përgjigjja për " Pretendimi 39" Ne situacionin e projektit dhe nga 3D kuptohet lehtësisht se OE me kodin 9090 ka menduar për shtigjet e ecjes dhe për ulëset ne parter.

Përgjigjja për "Pretendimi 40" Panelet solare janë një pike e forte e projektit propozimit me kodin 9090, kulmi i rrafshet i objekteve është shfrytëzuar për vendosjen e tyre, këto panele mund te gjenerojne energji për objektin ne ketë mënyrë duke e bere projektin me eficient, orientimi dhe vendosja e tyre është ideale dhe sipas standarteve, sasia e tyre noraml qe do duhet te llogariten ne punimin e projektit kryesor, andaj komentet për "Argumentin 40" janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 41, 42, 43": Rezervari i ujit ashti siç kërkohet ne detyre është vendosur brenda lokacionit, kjo vërehet shume saktë ne situacion dhe ne pamjet 3D, po ashtu nga situacioni shihet stazat e ecjes dhe rruga përgjatë gjeth parcelës, andaj komentet për "Argumentin 41, 42, 43" janë te pa baza dhe komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 44" OE 9090 ka krijuar 2 objekte shume te hapura dhe te lidhur me natyrën gjë qe është shume e arsyeshme dhe e duhur duke marr parasysh destinimin e objekteve, ne detyrën projektuese nuk janë dhënë sipërfaqe maksimale, ne detyrën projektuese janë dhënë sipërfaqet neto, andaj ka qene zgjedhje e projektuesve qe te vendosin për mënyrën e vendosjen se objektivave dhe hapësirave te përbashkëta. Po ti shikoni projektet te cilat ndërtohen ne bote me këtë destinim te objekteve, atëherë shohim qe këto objekte nuk janë vetëm për te vendosur pacientet ne to, këto objekte janë një mënyrë jetese për ta dhe ne si juri profesionale kemi vlerësuar shume larte fryem arkitektonike dhe konceptin e zhvillimit te projektit me shifrën 9090, ajo qe ka vlere dhe rendësi janë përmbushja e detyrës projektuese, lidhja e kthinave mes vete gjë qe ky operatore e ka bere ne mënyrën me te mire dhe si vlere te shtuar pastaj janë sipërfaqet e hapura lidhja me natyrën etj., pra nuk mund te quhet tejkalimi i sipërfaqeve pasi qe nuk është kërkuar diçka e tille ne detyrën projektuese, qëndrim ditore është mese i mjaftueshëm për 10 persona te cilët e shfrytëzojnë atë, edhe këndi leximi është paraqitur ne një mënyrë shume moderne andaj komentet për "Pretendimi 44" janë komplet te papërfillshme, subjektive dhe te pa baza.



Përgjigjja për “Pretendimi 45”: Projekti me kodin 9090 ne projektin e tij tek objekti i QIRSPK i ka emëruar sipas detyrës projektuese kthinat dhe ka bere mobilimin e tyre ne atë mënyrë qe te jene shume i lexueshëm projekti, andaj komentet për “Argumentin 45" janë komplet te papërfillshme dhe te pa baza.

Përgjigjja për “Pretendimi 46” Përsëri këto komente janë shume subjektive dhe jashtë kontekstit te detyrës projektuese.

Përgjigjja për “Pretendimi 47” Ne e kemi vlerësuar vendosjen e dhomës se vizitave ne pozitën me te përshtatshme te mundshme, pasi jo lidhet direkt me pjesën e reparteve dhe nga ana jashtme me mysafirët te cilët vinë për vizite, kjo hapësirë po ashtu ka hapje pre ndriçim dhe ne këtë mënyrë OE me kodin 9090 i është përmbajtur detyrës projektuese dhe ka bere një zgjidhje shume te mire funksionale, po ashtu e ka edhe pjesën e portës hyrëse, andaj komentet për " Pretendimi 47" janë komplet te papërfillshme dhe te pa baza.

Përgjigjja për “Pretendimi 48, 49, 50” Ne këtë faze te projektit nuk është marre parasysh aq shume vendosja e shtyllave dhe lëshime te tjera teknike te cilat nuk mund te konsiderohen a gabime pasi kemi konsideruar qe ato mund te rregullohet lehtësisht ne projektin kryesore, andaj komentet për “Pretendimi 48, 49, 50” janë te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 51” Përsëri nuk e di se nga i ka marr këto “standarte" pala ankuese, por këto WC janë komplet te pranueshme dhe shume funksionale, andaj komentet për “Pretendimi 51” janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 52” Disa lëshime teknike nuk i kemi marre parasysh për shkak edhe te volumit te përmbajtës, mirëpo ne baze te organizimit te përmbajtës dhe hapësirës si dhe vendosjes se saj kemi kuptuar shume lehtë se kjo kthine e emruar “2.5” është “Njësia rehabilituese vokacionale”, e kuptojmë plotësisht palën ankuese nëse ata nuk ka arritur ta kuptojnë se çfarë destinomi ka ajo hapësire, mirëpo po e përsërisim qe lëshime teknike ndodhin rendësi ka funksionaliteti dhe zgjidhja, sa për sqarim, njësia rehabilituese vokacionale është hapësire ne te cilën pacientet dhe banoret ne atë objekt shkojnë ne ato hapësire për tu angazhuar ne pune dhe për te kaluar një pjese te ditës aty , andaj komentet për “Pretendimi 52" janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 53”: Përsëri disa lëshime teknike nuk janë marre parasysh, sipërfaqe ne detyrën projektuese kemi konsideruar si sipërfaqe minimale andaj ne qofte se një hapësirë e ka kaluar sipërfaqen minimale nuk mund te konsiderojmë asesi qe është gabim, për shkak te disa lëshimeve dhe mungesave ne projektin me kodin 9090 ka marr vetëm 77.01 pike dhe jo 100, andaj komentet për “Pretendimi 53" janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 54”: Kantina për pacient është vendosur ne pozitën e saj me te mire te mundshme për shkak se ajo hapësirë duhet te këtë qasje nga pacientet (pacientet e shoqëruar nga stafi) dhe nga pjesa e stafit profesional, sipërfaqe ne detyrën projektuese kemi konsideruar si sipërfaqe minimale andaj ne qofte se një hapësirë e ka kaluar sipërfaqen minimale nuk mund te konsiderojmë asesi qe është gabim, kjo hapësirë edhe brenda saje ka një zgjidhje shume te përshtatshme funksionale ku është e ndare dhe me qasje te veçante edhe pjesa e kuzhinës, andaj komentet për “Pretendimi 54": janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 55”: Pala ankuese ne këtë pike ka te drejte mirëpo, ne baze te sipërfaqeve dhe madhësisë se kthinave atëherë kemi konsideruar qe ky problem mund te zgjidhet shume lehtë ne projektin kryesor.

Përgjigjja për “Pretendimi 56”: OE me kodin 9090 i është përmbajtur detyrës projektuese edhe tek pjesa e Shërbimeve Teknike, edhe radhitja dhe vendosja e tyre është shume e përshtatshme, kanë qasje nga jashtë dhe lidhje me kthinat tjera, madje ne detyrën projektuese askund nuk thotë se këto kthina duhet te vendosen nga apo larg, po ashtu nëse shohim ana logjike këto kthina janë shume te përshtatshme, andaj komentet për “Pretendimi 56” janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 57” Ne projektin me kodin 9090 nëse e shohim projektin e ndërtesës se ISSH projektin ne fjale ka bere një zgjidhje shume te përshtatshme te vendosjes se hapësirave për mbeturina, tek objekti i QIRSKP ky projekt nuk e ka paraqitur këtë shënim askund andaj edhe nuk ka marr piket maksimale, mirëpo duke e pasur parasysh zgjidhjen tek objekti tjetër kemi konsideruar qe ky lëshim mund te zgjidhet lehtë ne projektin kryesor, andaj konsiderojmë qe komentet për “Pretendimi 57” janë te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 58”: Depot tek pjesa e kuzhinës janë vendosur ne mënyrën e duhur, nuk ka nevojë te organizohen depot mjafton shënimimi i tyre dhe vendosja e tyre e drejt, lidhja e tyre me jashtë dhe me pjesën e kuzhinës, andaj komentet për " Pretendimi 58" janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 59” Ky koment është shume joprofesional dhe i pa papranueshëm, lavaderi është tamam ne vendin ku duhet te jete, tek pjesa e shërbimeve teknike dhe pjesa e personelit, lavanderi ka qasje përmes dyerve me pjesën e reparteve dhe konsiderohet si një hapësirë teknike ku duhet vetëm personeli te këtë çasje, andaj komentet për “Pretendimi 59” janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 60”: OE me shifrën 9090 ne projekt propozimin e tij ka respektuar detyrën duke i vendosur hapësirat e Lavanderis me sipërfaqet e kërkuara dhe ne lidhje te duhur njëra me tjetrën, te gjitha kthinat kanë ndriçim natyral qe është shume e rëndësishme, për mos vendosjen e makinave përballë njëra tjetrës nuk kemi dhënë piket maksimale, edhe pse gjera te tilla mund te permisohen shume lehtë ne projektin kryesor, andaj komentet për " Pretendimi 60” janë te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 61”: Përsëri ne projekt propozimin me shifrën 9090 tek pjesa e lavanderis dy kthina kanë shënimimin 5.3, mirëpo si tërësi kjo hapësirë e lavanderis ka 4 kthina te ndara ashtu siç kërkohet ne detyrën projektuese, OE me kodin 9090 edhe këtu ka bere një lëshim teknik, mirëpo ajo qe ka rëndësi ka qene paraqitja e kthinave, edhe për këtë lëshim projektin ne fjale nuk ka marre piket maksimale, andaj komentet për “Pretendimi 61” janë te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 62”: Kthina e pa emërtuar ne katin 1 është një korridor teknik, kjo sipas skemave 2D dhe 3D te cilat janë paraqitu ne projekt propozimin e OE me kodin 9090, është një lëshim nga ana e OE 9090 i cili nuk e ka emërtuar këtë kthine edhe ne planimetrin e kateve, mirëpo funksionalitet kjo hapësirë është shume ne rregull pasi lidhet ne te gjitha katet dhe me pjesën teknike te ndërtesës, andaj komentet për “Pretendimi 62” janë te papërfillshme.

Përgjigjja për “Pretendimi 63”: Tek kati i pare dhe kati i suteranit është organizuar nga një repart i cili për nga ana funksionale është i njëjti me repartet ne katet tjera, qe d.m.th. ka një funksion

dhe organizim shume te mire, po ashtu ne këtë mënyrë projektuesi ka shfrytëzuar dhe respektuar terrenin ekzistuese duke i vendosur objekte ne sistemin "kaskade" po ashtu ka projektuar sipas detyrës projektuese dhe sipas destinimit te objektit, pjesa e hapësirës se komunikimit ne këto kate është "me madhe" mirëpo meqenëse ne detyrën projektues nuk ka pasur ndonjë kufizim për hapësirat e përbashkëta nuk e kemi konsideruar këtë gjë si një defek pasi qe objekti ne tersi ka funksionin dhe lidhshmërinë mes reparteve dhe kthinave shume te mire, andaj komentet për "Pretendimi 63" janë te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 64": Ne bazën e katit Setrën te objekti i QIRSKP pika 5.1 (ashtu siç është e shkruar ne detyrën projektuese) gjendet ne afërsi te pjesës se kuzhinës dhe tyrezaris, qe d.m.th. kjo hapësirë nuk mungon ashtu siç pretendon pala ankuese, andaj komentet për "Argumentin 64" janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 65":Ne situacionin e ofruar nga OE me kodin 9090 ne fletën ku është paraqitur Situacioni mund te shihet qarte se është i vendosur "Mini anfiteatri" i cili është i vendosur ne mes ty terreneve sportive qe d.m.th. kjo hapësirë nuk mungon ashtu siç pretendon pala ankuese, andaj komentet për "Argumentin 65" janë komplet te papërfillshme.

Përgjigjja për "Pretendimi 66": Ne situacionin e ofruar nga OE me kodin 9090 ne fletën ku është paraqitur Situacioni dhe ne pamjet 3D mund te shihet kjarte se është i vendosur liqeni artificial me ujëvarën i cili është i vendosur pran hyrjes ne parcele ne pjesën perëndimorë te parcelës qe d.m.th. kjo hapësirë nuk mungon ashtu siç pretendon pala ankuese, andaj komentet për "Argumentin 66" janë komplet te papërfillshme

Përgjigjja për "Pretendimi 67" Për këtë koment jemi përgjigjur edhe me herët, ne Situacionin dhe pamjet 3D te projekt propozimit me kodin 9090 shifet qarte se është i paraqitur rezervuari i ujit, qe d.m.th. kjo hapësirë nuk mungon ashtu siç pretendon pala ankuese, andaj komentet për "Pretendimi 67" janë komplet te papërfillshme.

Konkluzion i Komisionit Profesional: Jemi munduar qe ne përgjigjet tona te jemi sa me objektiv ashtu siç ka qene edhe vlerësimi jone, përgjigjet tona këtu kanë edhe material sqarues profesional se si duhet projektuar objekte te tilla. "Argumentet" e palës ankuese ne këtë rast i konsiderojmë me shume si subjektive, nganjëherë edhe te çuditshme, duke u nisur ne disa prej argumenteve qe ata kane listuar.

Konsiderojmë qe projekti me kodin 9090 pa dyshim ka marre piket e merituar, njësoj sikur se projektet tjera pjesëmarrëse, projekti me kodin 9090 ka lëshime te vogla, po ashtu edhe projektet tjera, mirëpo projekti me kodin 9090 ka bere zgjidhjen me te mire funksionale, lidhjen e kthinave ne mes vete, shfrytëzimin e terrenit, pamjen 3D te objektit dhe duket se ky projekt e ka kuptuar shume mire detyrën projektuese dhe destinimin e objekteve gjë qe është element kryesor. OE me kodin 9090 ka respektuar ne maksimum Detyrën Projektuese të dhënë nga AK Ministria e Shëndetësisë dhe i gjithë vlerësimi jonë është bërë duke pare Detyrën Projektues me atë çka ka dhënë OE me kodin 9090 ne Projektin Ideor të tij. Ne si juri profesionale konsiderojmë se objekte të natyrës së tillë bëhen "njëherë në 100 vite" dhe e rëndësishme tek këto objekte është së pari funksioni dhe lidhja e hapësirave ne mes vete si dhe forma arkitektonike e cila duhet të jete e kohës dhe ti qëndroj asaj, andaj ne si juri duke pare dhe objekte te ngjashme në vende të ndryshme të Botës kemi vlerësuar se OE me kodin 9090 ka bërë Projektin më të mire nga të gjithë OE pjesëmarrës ne këtë Konkurs Projektimi. Duke u nisur nga Vlerësimi jone si Juri Profesionale për disa lëshime teknike qe kanë bërë të gjithë OE pjesëmarrës në këtë Konkurs Projektimi ne i kemi poentuar me pike më të ulëta ashtu siç e kemi vepruar duke e poentuar edhe

projektin e OE me kodin 9090 ku ne i kemi dhënë atyre 77.01 pikë nga 100 pikët maksimale sa kanë qene.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16.02.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues ndërsa me datën 20.02.2024 ka autorizuar ekspertin teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 106/2024, ndërsa me datë 05.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues si dhe ekspertit teknik me nr. 2024/106 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërkaq edhe OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

3. Lidhur me pretendimet e OE “Kodi“0811” eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/106 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës: “Me datën: 08.02.2024 OE “me kodin 0811” Prishtinë, ka parashtruar ankesë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Kompleksin Qendra e ISSH dhe QIRSKP ne Shtime” me numër të prokurimit 206-23-10983- 4-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues MSH. Ekspertja shqyrtuese sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me përzgjedhjen e jurisë, konsideroj se mbetet në diskrecion të AK-së të bëjë përzgjedhjen dhe analizimin mbi përcaktimin e jurisë duke respektuar nenin 80 par. 1 dhe 2 të LPP-së, citat LPP" Neni 80 Përbërja dhe Vendimet e Jurisë 1. Juria duhet të përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizikë. Këta persona do të caktohen nga autoriteti kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të jurisë duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij. 2. Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.”

Konstatimi i parë (I):“Ekspertja shqyrtuese meqenëse nuk posedon profesionin adekuat për shqyrtimin dhe analizimin e pretendimeve ankimore dhe argumenteve të parashtruara, atëherë ka kërkuar që të angazhohet ekspert teknik. Eksperti teknik me datën 21.02.2024 me Autorizim është angazhuar në cilësinë e ekspertit teknik për shqyrtimin e ankesës së parashtruar nga OE me kodin 0811. Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore. Eksperti teknik nga analiza e

projektit të OE fitues dhe nga shqyrtimi i pretendimeve të OE ankues konstaton se argumenti 1 është i pa bazuar sepse Projekti i OE fitues edhe në formën e paraqitur ka zgjidhje teknike të cilën e mundësojnë fondimin e objektit edhe në pjesët ku duhet bërë mbushje, siç edhe është cekur përmes pilotave. Ndonjëherë zgjidhja më e mirë funksionale e objekteve në terene të tilla imponon edhe përdorimin e teknikave më të veçanta inzhinjerike për realizimin e një objekti funksionale. Duke u bazuar në atë se çfarë u sqarua më lartë pretendimi i ngritur në ankesë është i pabazuar.”

Konstatimi i dytë (II): “Eksperti teknik sqaron se në detyrën projektuese është përcaktuar se hyrjet do të locohen në të njëjtin vend, por të ndara, pra në specifikimet e detyrës projektuese nuk përcaktojnë ndonjë kërkesë tjetër. OE fitues ka paraqitur dy hyrje sipas kërkesës projektuese dhe OE ankues , nuk ka asnjë bazë e qartë për pretendimin e tyre. Eksperti konstaton se lidhja funksionale mes dy komplekseve është e mirë. Kjo përfshin vlerësimin e lehtësisë së qarkullimit midis dy ndërtesave dhe lidhja mes komplekseve të ndërtimit përputhet me specifikimet dhe kërkesat e detyrës së projektimit. Duke u bazuar në atë se çfarë u sqarua më lartë pretendimi i ngritur në ankesë është i pa bazuar.”

Konstatimi i tretë (III): “Eksperti teknik sqaron se është bërë e qartë që në detyrën projektuese është përcaktuar qartë organizimi i hapësirave të brendshme dhe lidhja mes dy komplekseve të ndërtimit (ISSH dhe QIRSKP). Nga analizimi i projektit të OE fitues është vërejtur se planifikimi dhe pozicionimi i objektit në parvelë dhe lidhja funksionale mes dy objekteve është e mirë. Po ashtu, është në kompetencë të Autoritetit kontraktues që përmes jurisë profesionale të vlerësojë me tutje projektin nga aspekti arkitektonik. Sa i përket çështjes estetike është kompetencë e vlerësimit nga ana e komisionit profesional, ndërsa sa i përket aspektit teknik në lidhje me ndërlidhjen fizike mes dy objekteve OE fitues ka respektuar kërkesat e specifikimeve të detyrës projektuese në lidhje me ndërlidhjen fizike mes dy objekteve. Kjo përfshin ndarjen fizike dhe rrethojën e pa kalueshme nga këmbësoret, siç është kërkuar në detyrën projektuese. Me këtë argumente pretendimi nuk ka bazë të mjaftueshme dhe nuk është i bazuar.”

Pretendimi i katërt (IV): “Është vërejtur se në detyrën projektuese nuk është përcaktuar sipërfaqja maksimale e lejuar dhe nuk është caktuar vlerë investive, duke mos përcaktuar ndonjë kufizim rreth sipërfaqeve apo vlerës investive. Andaj, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin në bazë të kompetencave profesionale, duke vlerësuar zgjedhjen funksionale të objektit. Natyra e konkursit të projektimit është një proces fillestar që ndihmon në zgjedhjen më të qëndrueshme të projektimit në pajtim me kërkesat e dhëna në detyrën projektuese. Kjo tregon se ka një shkallë fleksibiliteti për të ndryshuar ose përmirësuar projektin gjatë fazës finale, në përputhje me kërkesat e specifikimeve. Pretendimi i OE ankues lidhur me hapësirat nuk mund të pranohet si i bazuar, pasi eksperti teknik ka konstatuar se oferta fituese ka përmbushur në përgjithësi kërkesat e detyrës projektuese dhe ka bërë zgjedhje funksionale për projektin.”

Konstatimi i pestë (V): “Eksperti konsideron se në detyrën projektuese nuk është dhënë si kriter ose kërkesë zgjidhja detale konstruktive e objektit, por vetëm si ide fillestare dhe e realizueshme. Në projektin kryesor sigurisht që zgjidhja konstruktive do të përcjell dhe do të përshtatet zgjidhjes funksionale në pjesën më të madhe të projektit. Derisa nuk ka ndonjë devijim shumë të theksuar atëherë në këtë fazë ky argument konsiderohet si i pa bazuar sepse theksi në këtë fazë të projektit është tek ofrimi i një projekti me zgjidhje funksionale. Pretendimi i ankuesit nuk është i bazuar.”

Konstatimi i gjashtë (VI): “Eksperti sqaron se pretendimi i ofetuesit të ankimuar lidhur me mungesën e pozicionimeve të caktuara në projektin e OE fitues nuk mund të pranohet si e bazuar. Kjo për arsye se, siç është sqaruar, detyra projektuese nuk ka kërkuar që këto elemente të paraqiten si pjesë të veçanta të projektimit. Për më tepër, eksperti ka vërejtur se projektimi përmban pozicionime që janë të përfshira në planimetri dhe situacionin e kateve, duke u bazuar në kërkesat e detyrës projektuese dhe në tabelën e hapësirave të specifikuar. Prandaj, është e arsyeshme të konkludohet se OE fitues ka paraparë përfshirjen e këtyre hapësirave të veçanta, dhe kështu pretendimi i ofruesit të ankimuar nuk ka bazë të mjaftueshme.”

Konstatimi i shtatë (VII): “Në lidhje me pretendimin në fjalë, është e rëndësishme të theksohet se në këtë fazë të projektit, zgjidhjet e sakta dhe detajet specifike zhvillohen gjatë fazës së projektit kryesor. Në fazën fillestare të projektit, objektivi kryesor nga AK ka qenë paraqitja e një vizioni të qartë dhe funksionalitetit të përgjithshëm. Për të arritur këtë objektivi, është vënë theks në përmbushjen e kërkesave themelore të funksionalitetit, duke përfshirë hapësirat dhe kërkesat për pushime. Megjithatë, është e rëndësishme të përmendet se detajet më të hollësishme, siç janë pajisjet e sigurisë dhe karakteristikat e pushimeve, duhet të përmbushen në përputhje me rregulloret dhe kërkesat e specifikuar përkatëse gjatë fazës së projektit kryesor. Detajet më të hollësishme dhe të specifikuar ka mundësi që të adresohen në fazën e mëtejshme të zhvillimit të projektit.”

Konstatimi i tetë (VIII): “Bazuar në analizën e projektimit të OE fituese, eksperti teknik ka vlerësuar se disa çështje, si hapja e dritareve dhe mosparaqitja e gardhit, janë çështje minore dhe përcaktohen në fazën kryesore të objektit. Për më tepër, edhe mundësia e emërimit të kthinave konsiderohet si një çështje teknike e rregullueshme. Ndërkohë, disa gabime teknike të vogla, si mungesa e dimensioneve të saktësuar për nevoja të kalkulimit më të detajuar, janë vërejtur. Megjithatë, eksperti vlerëson se këto gabime nuk kanë ndikim të madh në vlerësimin e projektit në tërësi. Për këto arsye, pretendimi i OE ankues për mosparaqitjen e disa elementëve si hapja e dritareve dhe mosparaqitja e gardhit nuk mund të konsiderohet si i bazuar. Ndërkaq, për gabimet teknike të vogla, ata vlerësohen si të korigjueshme dhe nuk kanë ndikim të madh në vlerësimin e projektit. Pretendimi nuk është i bazuar.”

Konstatimi i nëntë (IX): “Pretendimi i OE fitues për paraqitjen e portave hyrëse për të dy objektet në mënyrë të përshtatshme dhe funksionale në situacionin 2 është një arsyetim i rëndësishëm dhe i bazuar. Kjo për arsye se, sipas analizës së ekspertit teknik, në detyrën projektuese nuk është kërkuar një projekt i veçantë për këto hapësira. Për më tepër, juria profesionale ka vlerësuar se përmbushja e kërkesave të specifikuar në situacion, përfshirë paraqitjen e portave hyrëse, është e mjaftueshme për tu vlerësuar në këtë fazë të projektimit. Kjo tregon se OE fitues ka zgjedhur një qasje praktike dhe të përshtatshme për të përmbushur kërkesat e detyrës projektuese. Në këtë fazë nuk do duhet të punohet project i veçantë për këto hapësira, mjafton paraqitja e tyre në situation. Andaj pretendimi nuk është i bazuar.”

Konstatimi i dhjetë (X): “Eksperti teknik vlerëson se pretendimi i ofruesit të ankimuar nuk ka bazë, duke mbështetur faktin se ndriçimi nga atrium konsiderohet si ndriçim natyral. Kjo përfshihet në vlerësimin e funksionalitetit të hapësirës së atriumit në projektin e OE fitues. Prandaj, pretendimi i OE ankues konsiderohet i pa bazuar.”

Konstatimi i njëmbëdhjetë (XI): “Pretendimi është i pa bazuar për shkak se në detyrën projektuese nuk është përcaktuar asnjë kërkesë specifike lidhur me vendndodhjen e ËC-ve. Për këtë arsye, vlerësimi dhe përshtatshmëria e vendosjes së tyre është në kompetencën e jurisë

profesionale. Prandaj, pretendimi i ankimesit është i pa bazuar.”

Konstatimi i dybëdhjetë (XII): “Pretendimi është shume minor, pasi vendndodhja e WC-së është e lehtë për tu transformuar në banjë sipas nevojës.”

Konstatimi i trembëdhjetë (XIII): “Eksperti teknik vlerëson se lidhur me pretendimin e OE ankues për çështjen në fajlë nuk ka pasur ndonjë kërkesë specifike që WC do duhej të kenë korridor të veçantë. Pretendimi nuk është i bazuar.”

Konstatimi i katërbëdhjetë (XIV): “Sipas detyrës projektuese është kërkuar që ne kuadër të fizioterapi dhe pajisjeve tjera të ketë banjo dhe tualete, dhe sipas analizës së projektit të OE fitues vërejmë se është respektuar kjo kërkesë. Ndërsa, hapësira për Hidroterapi nuk shihet se është në detyrën projektuese. Andaj vlerësojmë se ky pretendim i ngritur është i pabazuar.”

Konstatimi i pesëmbëdhjetë (XV): “Eksperti teknik pajtohet me vlerësimin e jurisë profesionale se dhoma e pritjes është paraqitur në mënyrë të mirë dhe se mungesa e dritës direkte nuk paraqet një mangësi të rëndë, duke marrë parasysh se kjo është një dhomë për vizitorë dhe jo për qëndrim të gjatë. Prandaj, pretendimi i ofruesit të ankimit është i pa bazuar.”

Konstatimi i gjashtëmbëdhjetë (XVI): “Eksperti teknik vlerëson se argumenti lidhur me çështjen e ËC-së nuk është i bazuar, pasi edhe kjo çështje në detyrën projektuese nuk është specifikuar me saktësi. Prandaj, pretendimi i ofruesit të ankimit është i pa bazuar.”

Konstatimi i shtatëmbëdhjetë (XVII): “Ky pretendim nuk qëndron sepse sipas detyrës projektuese dhoma është caktuar si dhomë për qëndrimin e infermierëve për repartin A1, ndërsa për pacient kur kanë nevojë për shërbimet e ambulantë atëherë pacientët dërgohen në ambulante e përbashkëta. Argumenti është i pa bazuar.”

Konstatimi i tetëmbëdhjetë (XVIII): “Eksperti teknik ka vlerësuar se është e rëndësishme që të respektohen kërkesat minimale për dimensionet e dhomave gjatë projektimit. Megjithatë, uniformiteti për dimensione të njëjta për secilën dhomë mund të kufizojë organizimin më të mirë për hapësira të tjera. Prandaj, është e rëndësishme që të respektohen dimensionet minimale të kërkuara, ndërsa është e lejuar një shkallë e caktuar fleksibiliteti për të përshtatur nevojat specifike të organizimit të hapësirës. OE fitues ka respektuar këtë. Andaj pretendimi është i pa bazuar.”

Konstatimi i nëntëmbëdhjetë (XIX): “Eksperti teknik nga vlerësimi i projektit të OE fitues ka vlerësuar se projekti është hartuar në pajtim me kërkesat e detyrës projektuese. Mënyra e parashikimit apo prezantimit të projektit nga OE me kodin 9090, tualetet me qasje nga koridori qendror dhe lidhje me garderobat, është një propozim projektues që juria profesionale e ka vlerësuar si shfrytëzim më efikas dhe fleksibil të tualeteve. Andaj pretendimi është i pa bazuar.”

Konstatimi i njëzetë (XX): “Eksperti teknik vlerëson se argumenti është i pa argumentuar sepse nuk ka bazë duke marrë parasysh se OE fitues ju ka përmbajtur kërkesave të detyrës projektuese.”

Konstatimi i njëzetë e një (XXI): “Eksperti teknik vlerëson se ky argument është i pa bazuar duke marrë për bazë se projekti OE fitues në përgjithësi ju ka përmbajtur kërkesave të detyrës projektuese.”

Konstatimi i njëzetë e dy (XXII): “Eksperti teknik sqaron se pasi sipas detyrën projektuese është kërkuar se lidhja e kateve të objekteve, zona e frekuentimit nga rezidentet duhet të bëhet me pjerrina dhe jo me shkalle, atëherë vërejmë se OE fitues ka respektuar këtë kërkesë. Pretendimi është i pa bazuar.”

Konstatimi i njëzetë e tre (XXIII): “Eksperti teknik sqaron se në detyrën projektuese tek objekti ISSH, Reparti A3 pika 7.1 është përcaktuar dhoma (12m2) për qëndrimin e infermiereve për atë repart, dhe OE fitues e ka paraparë këtë hapësirë, ndërsa ajo çka pretendon OE ankues nuk qëndron sepse siç shihet për pacientë që kanë nevojë për shërbime ambulante është paraparë që të shërbejë ambulanta e përbashkët. Po ashtu duhet të përsërisë se kjo çështje është në kompetencën e komisionin të vlerësimit. Andaj pretendimi është i pa bazuar.”

Konstatimi i njëzetë e katër (XXIV): “Eksperti teknik vlerëson se OE me kodin 9090 lidhur me pretendimin e OE ankues, projektin e ka planifikuar sipas kërkesës së detyrës projektuese. Argumenti nuk është i bazuar.”

Konstatimi i njëzetë e pestë (XXV): “Eksperti teknik lidhur me çështjen e ngritur tek argumenti 25 vlerëson se OE ankues ka të drejtë sepse shihet se në këtë aspekt OE fitues vërehet se ka bërë lëshime teknike në këtë rast.”

Konstatimi i njëzetë e gjashtë (XXVI): “Eksperti teknik vlerëson se argumenti është pjesërisht i bazuar, kjo sepse vërehet se OE fitues ka bërë disa lëshime teknik, po qe kjo sërish mbetet çështje që rregullohet në projektin final. Argumenti është pjesërisht i bazuar.”

Konstatimi i njëzetë e shtatë (XXVII): “Nga analizimi i projektit vërejmë se këto argumente janë pjesërisht të bazuara sepse format e parregullta të dhomave të hapësirave edhe mund të ndikojnë në funksionalitetin e objektit. Mirëpo këto hapësira janë çështje jo substanciale në raport me objektin si tërësi dhe në projektin final rregullohen. Argumenti është pjesërisht i bazuar.”

Konstatimi i njëzetë e tetë (XXVIII): “Eksperti teknik konsideron se çështja e vendosjes së dyerve është një çështje që finalizohet në projektin kryesor. Vendosja e dyerve përfundon dhe përcaktohet gjatë zhvillimit të projektit kryesor. Pretendimi është i pa bazuar.”

Konstatimi i njëzetë e nëntë (XXIX): “Argumenti është i bazuar pasi në detyrën projektuese, në pikën 9.6, është kërkuar hapësira për vendosjen e bukës, ndërsa në projektin e OE fitues nuk është parashikuar kjo hapësirë.”

Konstatimi i tridhjetë (XXX): “Në detyrën projektuese, në pikën 9.7, është kërkuar hapësira për frigoriferin shtëpizë (komores), dhe duke shqyrtuar projektin e OE fitues, vërehet se kjo hapësirë është paraqitur. Ndërsa, çështja e paraqitjes së dritareve nuk ndikon në funksionalitetin e dhomës dhe mund të korrigjohet.”

Konstatimi i tridhjetë e një (XXXI): “Eksperti teknik konsideron se çështja e WC nuk mund të konstatojmë se janë jashtë standardeve të pranueshme dhe OE fitues si hapësira i ka parashikuar ato. Argumenti është i pa pranueshëm.”

Konstatimi i tridhjetë e dy (XXXII): “Eksperti teknik vlerëson se në detyrën projektuese nuk është përcaktuar një çështje e tillë, andaj si vlerësim final i takon AK që përmes jurisë profesionale të vlerësojë këtë. Pretendimi nuk është i bazuar.”



Konstatimi i tridhjetë e tre (XXXIII): “Eksperti teknik konsideron se edhe në mungesë të paraqitjes grafike të derës në projektin ideor, ekziston mundësia për të ndarë korridorin e ecjes nga restoranti. Pretendimi nuk është i bazuar.”

Konstatimi i tridhjetë e katër (XXXIV): “Eksperti teknik thekson se vërehet së ne kaldaje nuk ka të paraqitu asnjë mobilim dhe vendosja e ogjakut definohet gjatë fazës së projekti kryesor e cila pastaj gjithsesi që duhet të përputhet dhe mos të ndërhyje në etazhat e sipërme. Andaj vlerësojmë se ky pretendim i ngritur nuk mund të merret për bazë.”

Konstatimi i tridhjetë e pestë (XXXV): “Eksperti teknik vlerëson se argumenti është pjesërisht i bazuar pasi që paraqitja teknik nuk është kriet për vlerësimin e projektit dhe paraqitet vetëm në raste të rralla ky argument nuk mund të konsiderohet si i bazuar.”

Konstatimi i tridhjetë e gjashtë (XXXVI): “Eksperti teknik konsideron se paraqitja teknik nuk është kriter për vlerësimin e projektit dhe paraqitet vetëm në raste të rralla ky argument nuk mund të konsiderohet i bazuar.”

Konstatimi i tridhjetë e shtatë (XXXVII): “Eksperti teknik vlerëson se OE fitues ka bërë një planifikim të hapësirave edhe sa i përket çështjes së mbeturinave dhe gjithsesi se ky aspekt është në kompetencën e jurisë profesionale të vlerësoj një planifikim të tillë.”

Konstatimi i tridhjetë e tetë (XXXVIII): “Eksperti teknik vlerëson se është një zgjidhje e pranueshme funksionale edhe kjo mënyrë sepse garazhda është vendosur në suterren. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se qasja është lejuar vetëm për personelin dhe nuk ndikon në funksionalitetin e hapësirave të tjera. Kjo strategji ka ruajtur hapësirën e jashtme për prioritete të tjera, duke e bërë atë një zgjidhje të favorshme për këtë kontekst. Pretendimi nuk është i bazuar.”

Konstatimi i tridhjetë e nëntë (XXXIX): “Pasi në sitacion shihen shtigjet e ecjes dhe ulëset, pretendimi i OE ankues është një çështje e vogël edhe sipas vlerësimit të AK edhe rregullohet lehtësisht. Eksperti teknik konsideron se pretendimi i OE ankuesin lidhje me shtigjet e ecjes dhe ulëset në situatën e dhënë është një çështje e vogël dhe lehtësisht e rregullshme, andaj nuk mund të merret si i bazuar.”

Konstatimi i katërdhjetë (XL): “Eksperti teknik sqaron se kërkesa e OE ankues nuk është e qartë, nuk është sqaruar sipas cilave kërkesave. Prandaj, është e rëndësishme që OE ankuesi të përcaktojë dhe të paraqesë pretendimet e tij në mënyrë të qartë dhe të detajuar, duke përfshirë referencat specifike të detyrës projektuese ose të dokumentacionit të lidhur për të lehtësuar vlerësimin e AK-së dhe zbatimin e veprimeve të nevojshme në rast se pretendimi është i bazuar.”

Konstatimi i katërdhjetë e një (XLI): “Eksperti teknik konsideron se pretendimi është pjesërisht e bazuar, mirëpo nga raporti i vlerësimit shohim se OE fitues nuk është vlerësuar apo poentuar me piket maksimale. Andaj pretendimi nuk mund të merret për bazë.”

Konstatimi i katërdhjetë e dy (XLII): “Eksperti teknik konsideron se OE fitues ka respektuar kërkesat e detyrës projektuese kjo mund të shihet edhe nga prezantimit i projektit ne pamjet 3D.”

Konstatimi i katërdhjetë e tretë (XLIII): “Eksperti teknik konsideron se OE fitues ne stacion ka paraqitur stazat e ecjes dhe rrugën përgjatë gjithë parcelës, çështje e vendosjet së ulëseve për pushim vendoset në finalizim të projektit.”

Konstatimi i katërdhjetë e katërt (XLIV): “Eksperti sqaron se në detyrën projektuese janë përcaktuar vetëm sipërfaqet neto të hapësirave, duke e lënë zgjedhjen e hapësirave të përbashkëta në dorë të projektuesve. Nga analiza e projektimit me shifrën 9090, konstatohet se projekti është në përputhje me detyrën projektuese dhe përmban vetëm ato elemente të përcaktuara në detyrë. Prandaj, nuk mund të vlerësojmë për kritere apo kërkesa të tjera përveç atyre të përcaktuara në detyrën projektuese. Kështu, pretendimi i ofruesit të ankimuar nuk është i bazuar.”

Konstatimi i katërdhjetë e pestë (XLV): “Eksperti teknik vlerëson se çështja e emërimit është një pjesë teknike e projektimit, dhe në këtë rast, nuk është shfaqur ndonjë pengesë ose paqartësi që mund të ndikojë në vlerësimin e objektit. Ky argument trajton një çështje shumë bazike dhe për rrjedhojë, nuk mund të pranohet si i bazuar.”

Konstatimi i katërdhjetë e gjashtë (XLVI): “Eksperti teknik vlerëson se edhe pse në detyrën projektuese nuk është kërkuar vendosa e erë mbrojtësit, është standard i cili duhet të aplikohet dhe që çdo objekt duhet të ketë një erë mbrojtës për mbrojtje nga jashtë. Mirëpo parashikimi ere mbrojtësit mund të parashikohet në fazën e projektit kryesor duke marrë parasysh se është një detaj teknik i cili mund të rregullohet lehtë pa efektuar zgjedhjen teknike.”

Konstatimi i katër dhjetë e shtatë (XLVII): “Eksperti teknik konsideron se OE fitues në përgjithësi i është përmbajtur detyrës projektuese dhe nga aspekti i dizajnit është vlerësuar si i përshtatshme nga juria profesionale. Argumenti nuk mund të merret si i bazuar.”

Konstatimi i katër dhjetë e tetë (XLVIII): “Eksperti teknik gjatë vlerësimit teknik ka vërejtur se OE fitues nuk ka pasur edhe shume konsideratë në çështjet e detajeve teknike në lidhje me konstruksionin e objektit dhe ndikimin e elementeve konstruktive në organizimin e brendshëm të hapësirës. Mirëpo edhe nga raporti i vlerësimit i bërë nga Juria profesionale vërejmë se OE fitues nuk ka marrë poentimin maksimal për kriterin për organizimin e hapësirave, e cila edhe ka reflektuar vlerësimin e jurisë për këto gabime. Andaj pretendimi nuk është i bazuar.”

Konstatimi i katër dhjetë e nëntë (XLXIX): “Në detyrën projektuese është kërkuar vetëm pozicionimi i dhomës së mjekut, pa specifikuar ndonjë kërkesë të veçantë. Duhet të theksojmë se çështjet teknike të tilla zakonisht përfundojnë në fazën e projektimit kryesor. Prandaj, pretendimi i bërë nuk është i bazuar.”

Konstatimi i pesëdhjetë (L): “Argumenti është i bazuar mirëpo nga paraqitja vërehet se është gabim teknik.”

Konstatimi i pesëdhjetë e një (LI): “Eksperti teknik vlerëson se ky pretendim përsëritet në disa argumente dhe nuk ka ndonjë akt ligjor që rregullon specifikisht këtë çështje. Për këtë arsye, ky është një çështje estetike funksionale që në përgjithësi është në kompetencën e jurisë profesionale për vlerësimin dhe zgjedhjen e saj. Prandaj, pretendimi nuk mund të pranohet si i bazuar.”

Konstatimi i pesëdhjetë e dy (LII): “Në këtë fazë të projektit, zgjedhja funksionale e objektit ka prioritet mbi gabimet teknike të cilat mund të paraqiten. Autoriteti Kontraktues në këtë fazë është përqendruar kryesisht në funksionalitetin dhe cilësinë e projektit, duke pasur parasysh se ky është momenti klavesh për të siguruar një projekt me një funksionalitet të mirë dhe zgjedhje teknike të përshtatshme. Kjo vërehet edhe në kriteret për vlerësimin e projektit. Prandaj, pretendimi nuk është i bazuar.”

Konstatimi i pesëdhjetë e tretë (LIII): “Sipërfaqet e dhëna në detyrën projektuese janë kërkesa minimale të përcaktuara dhe nuk janë të caktuara me një saktësi të plotë, por si hapësira minimale. OE fituese në përgjithësi ka përmbushur kërkesat e detyrës projektuese, andaj paraqitja e hapësirave me dimensione më të mëdha nuk paraqet ndonjë arsye për të vlerësuar negativisht. Prandaj, pretendimi është i pa bazuar.”

Konstatimi i pesëdhjetë e katër (LIV): “Nga analizimi i projektit vërejmë se lidhur me këtë pretendim OE fitues ka paraqitur planin sipas detyrës projektuese, ndërsa çështje është po ashtu në përgjegjësinë e AK që përmes jurisë profesionale të vlerësojë këtë.”

Konstatimi i pesëdhjetë e pesë (LV): “Argumenti është i bazuar.”

Konstatimi i pesëdhjetë e gjashtë (LVI): “Eksperti teknik konsideron se në detyrën projektuese nuk është përcaktuar apo në kërkesë dhe nuk është ndonjë çështje esenciale afërsia e tyre që do duhet të ndikojë në vlerësim. OE fitues ka paraparë që të jetë qasja nga jashtë dhe lidhje me kthinat e tjera. Pretendimi nuk është i bazuar.”

Konstatimi i pesëdhjetë e shtatë (LVII): “Eksperti teknik sqaron se nga rishikimi i projektit por edhe nga raporti i vlerësimit ka vërejtur se OE fitues në lidhje me këtë çështje nuk ka marr pikët maksimale nga juria profesionale. Andaj ky pretendim është pasqyruar edhe në vlerësimin nga juria profesionale.”

Konstatimi i pesëdhjetë e tetë (LVIII): “Eksperti teknik vlerëson se kjo çështje lidhjet me organizimin estetik të projektit dhe sipas komisionit të vlerësimit është pranuar projekti si i tillë.”

Konstatimi i pesëdhjetë e nëntë (LIX): “Eksperti teknik vlerëson se lavanderi është vendosur në hapësirën ku janë vendosur edhe dhomat tjera teknike, me qasjen vetëm nga personeli. Përderisa kjo hapësirë është parashikuar dhe është vendosur është e pranueshme se për një projekt të tillë është e vështirë të planifikohet çdo gjë në përpikshmëri. Po ashtu këto janë hapësira sekondare teknike të cilat nuk kanë ndonjë ndikim substancial. Është e kuptueshme se për një objekt të tillë nuk mund edhe për çdo hapësirë të gjindet zgjidhja teknike.”

Konstatimi i gjashtëdhjetë (LX): “Eksperti teknik ka vërejtur se ky devijim veç se ka ndikuar në vlerësimin apo poentim nga juria profesionale.”

Konstatimi i gjashtëdhjetë e një (LXI): “Eksperti teknik vlerëson se OE fitues në projektin ka paraparë hapësirat, ka 4 kthina të ndara ashtu siç është kërkuar në detyrën projektuese, po ashtu kemi vërejtur se lidhur me këtë çështje OE fitues nuk ka marrë pikët maksimale. Ky pretendim veç se është trajtuar nga juria profesionale.”

Konstatimi i gjashtëdhjetë e dy (LXII): “Eksperti teknik konsideron se mungesa e emërtimit është lëshim teknik, ndërsa si hapësirë mund të konsiderohet në rregull sepse lidh shkallët nga korridori.”

Konstatimi i gjashtëdhjetë e tre (LXIII): “Eksperti teknik konsideron se pasi që nuk ka pasur ndonjë kufizim në detyrën projektuese, kjo çështje i takon jurisë profesionale që të vlerësojë funksionalitetin dhe gjithashtu nga raporti i vlerësimit vërehet se OE sa i përket shpenzimeve të mirëmbajtjes nga juria profesionale është vlerësuar me pikët maksimale.”

Konstatimi i gjashtëdhjetë e katër, pestë, gjashtë, shtatë (LXIV), (LXV), (LXVI), (LXVII): “Lidhur me Argentin 64,65,66 dhe 67 Eksperti teknik vlerëson se nga analiza e projektit të OE fitues, nga Situacioni vërejmë se këto hapësira janë përfshirë. Pretendimet nuk janë bazuar.”

Konkluzioni: “Duke u bazuar në sqarimet e dhëna më sipër, eksperti teknik fillimisht sqaron se Juria Profesionale në përgjithësi ka bërë një vlerësim sipas kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit, dhe nga vlerësimi vërejmë se edhe OE fitues nga Juria Profesionale nuk është vlerësuar me pikë maksimale, ku pasqyrohen mangësitë e identifikuar nga ana e tyre. Pasi që, në dosjen e tenderit kriteret për vlerësim dhe kërkesat janë me të përgjithësuar, pasi që kemi të bëjmë me fazën e përgatitjes së projektit ideor vërehet se juria profesionale ka bërë vlerësimin sipas kreativitetit të OE-ve ekonomik duke u bazuar në kriteret e kërkuara si; zgjidhja urbane, paisazhi, racionaliteti hapësinor objekteve dhe situacionit etj. Duhet theksuar se edhe në detyrën projektuese kërkesat për organizim të hapësirave shumica janë kërkesa të përgjithësuar dhe i janë lënë kreativitetit të OE, dhe rrjedhimisht projektet e OE janë vlerësuar sipas gjykimit profesional të Jurisë. Pretendimet për mangësitë në zgjidhjet teknike dhe paraqiten grafike të projektit janë vetëm një nen kriter ku edhe nga raporti i vlerësimit vërehet se OE fitues nuk është vlerësuar maksimalisht. Pretendimet e palës ankuese në disa raste nuk bazohen në kërkesat e detyrës projektuese, disa komente janë subjektivë dhe disa argumente nuk qëndrojnë. Shumica e pretendimeve janë të natyrës shume teknike dhe të detajizuara minimalisht, çështjet të cilat rregullohen gjatë përpilimit të projektit kryesor. Në këtë fazë ka qenë e rëndësishme koncepti i objektit, duke përfshirë koncepti hapësinor dhe zgjidhja urbane, funksionalitetin e zgjidhjes, shfrytëzimit racional të hapësirës, çështjen në përgjithësi estetike arkitekturore. Nga analizimi projektit të OE fitues kemi vërejtur se OE në përgjithësi i është përmbajtur kërkesave të detyrës projektuese, ku gjitha hapësirat që janë kërkuar në detyrën projektuese janë të përfshira në projektin ideor, me disa gabime teknik të cilat janë të korigjueshme gjatë fazës së projektit kryesor, derisa vlerësimi estetik i zgjidhjes së ofruar është kompetencë e AK përmes jurisë profesionale. Duke u bazuar në atë se çfarë u sqarua më lartë konsideroj se pretendimet e ngritura në ankesë janë të pa bazuara.”

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues si dhe ekspertit teknik mendimet e tyre janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tyre me rastin e vendosjes, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten edhe njëherë.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik ankues është e pabazuar.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e eksperteve, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar, ndërsa, ka vendosur tëmbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues “Kodi“0811” lidhur me

aktivitetin e prokurimit me “Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Kompleksin Qendra e ISSH dhe QIRSKP ne Shtime” me nr. të prokurimit: "206-23-10983-4-1-3".

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - "PROARCHITECTURE" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: